



Education International
Internationale de l'Éducation
Internacional de la Educación

The European
Students' Union



TË MËSUARIT ME STUDENTIN NË QENDËR

KOHA PËR NJË PARADIGMË TË RE NË ARSIM:
TË MËSUARIT ME STUDENTIN NË QENDËR



Education and Culture DG

Lifelong Learning Programme



European Commission
TEMPUS





European Commission

TEMPUS

“Student-Centred Learning. Toolkit for students, staff and higher education institutions.” This publication has been translated into Albanian through the Tempus project Supporting and Developing the Structures for QA at the Private Higher Education Institutions in Kosova.

TË MËSUARIT ME STUDENTIN NË QENDËR

KOHA PËR NJË PARADIGMË TË RE NË ARSIM:
TË MËSUARIT ME STUDENTIN NË QENDËR

Ju nuk mund t'ia mësoni njeriut të gjitha gjërat. Ju vetëm mund ta ndihmoni atë që t'i zbulojë ato brenda vetes së tij.

Galileo Galilei

Është e rëndësishme që nxënësit të sjellin diçka nga rruga, jo relevante me studimet e tyre; ata nuk janë këtu për të adhuruar atë që është e njohur, por për ta kontestuar atë.

Jacob Bronoëski



Education International
Internationale de l'Education
Internacional de la Educación

The European
Students' Union



MATERIALI PËR TË MËSUARIT ME STUDENTIN NË QENDËR

Përmbajtja

Angele Attard
Emma Di Iorio
Koen Geven
Robert Santa

Editimi dhe lektura

Angele Attard



Mbështetur nga Grupi Drejtues i Projektit T4SCL

Ligia Deca, Unioni i Studentëve Evropianë
Monique Fouilhoux, Arsimi Ndërkombëtar
(Education International)
Olav Øye, Unioni i Studentëve Evropianë
Milica Popovic, Arsimi Ndërkombëtar (Edu
cation International)
Robert Santa, Unioni i Studentëve Evropianë
Natalia Tarachiu, Unioni i Studentëve
Evropianë
Bert Vandenkendelaere, Unioni i Studentëve
Evropianë

Sipas udhëzimeve të Bordit Këshillëdhënës Ndërkombëtar

Prof. Lee Harvey, Shkolla e Kopenhagës për
Biznes, Danimarkë
Dr. Sybille Reichert, Ph.D, Konsulente për
Arsim të Lartë
Prof. Jussi Välimaa, Instituti për Hulumtime
Arsimore, Universiteti i Jyväskylä,
Finlandë
Prof. Kirsten Hofgaard Lycke, Fakulteti i
Edukimit, Universiteti i Oslos, Norvegji

Kopertinat

Hekuran Sokoli

Printimi

Shtypshkronja "KGT"

Data

Tetor 2010



Education and Culture DG

Lifelong Learning Programme

Ky botim është pjesë e projektit Koha për një Paradigmë të Re në Arsimit: Të mësuarit me studentin në qendër. Ky projekt është financuar me ndihmën e Komisionit Evropian. Ky botim pasqyron vetëm pikëpamjet e autorëve, dhe se Komisioni nuk mund të mbahet përgjegjës për ndonjë përdorim të mundshëm të informacionit që përfshihet këtu.

PËRMBAJTJA

1.	PARIMET DHE PËRKUFIZIMI	6
2.	PËRFITIMET	10
3.	LISTA VERIFIKUESE E SCL	14
4.	NDRYSHIMI I TË MENDUARIT	18
5.	ZBATIMI NGA MËSIMDHËNËSIT	28
6.	ZBATIMI NGA INSTITUCIONET	38
7.	RUAJTJA E NJË KULTURE TË SCL	46
8.	PËRCEPTIMET E GABUARA TË RËNDOMTA	54
9.	SCL DHE PROCESI I BOLONJËS	58
10.	LITERATURË PËR LEXIM TË MËTEJSHËM	66



SHKURTESAT

EACEA	Agjencia Ekzekutive Audiovizuale për Arsim dhe Kulturë
ECTS	Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve (European Credit Transfer System)
EI	Arsimi Ndërkombëtar
ESU	Unioni Evropian i Studentëve
LLL	Të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës
LLP	Programi për të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (Komisioni Evropian)
PBL	Të mësuarit bazuar në problemin
RPL	Njohja e të mësuarit të mëparshëm
SCL	Të mësuarit me nxënësin në qendër
T4SCL	Koha për një Paradigmë të Re në Arsim: Të mësuarit me studentin në qendër (Projekt i përbashkët i EI-ESU)

1 PARIMET DHE PËRKUFIZIMI

1.1 HYRJE

Kjo paketë e mjeteve është pjesë e projektit të titulluar Koha për një Paradigmë të Re në Arsim: Të mësuarit me studentin në qendër (T4SCL), i udhëhequr bashkërisht nga Unioni i Studentëve Evropianë (ESU) dhe Arsimi Ndërkombëtar (EI). Ky është një projekt i financuar nga BE-ja në kuadër të Programit Të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLP) dhe menaxhuar nga Agjencia Ekzekutive Audiovizuale për Arsim dhe Kulturë (EACEA).

T4SCL, si një iniciativë pionier, ka për qëllim të ndihmojë hartuesit e politikave në dizajnimin e strategjive dhe qasjeve të shëndosha për të mësuarit me studentin në qendër

SCL-ja është praktike dhe e arritshme, si dhe është shumë e dobishme për studentët.

(SCL) dhe për të rritur kapacitetin e studentëve dhe stafit të organizatave përfaqësuese që të jenë partnerë aktivë në përhapjen e kulturës së SCL-së në institucionet e arsimit të lartë nëpër Evropë. Projekti synon të ofrojë informata gjithëpërfshirëse lidhur me mjetet e nevojshme, sfidat dhe rrëfimet e suksesshme të SCL-së si bazë themelore për të mësuarit gjatë gjithë jetës (LLL). Ajo gjithashtu synon të ofrojë të dhëna për politikatat konkrete - gjatë dhe pas kohëzgjatjes së projektit - për

diskutimet e vazhdueshme sa i përket së ardhmes së Programit të BE-së për Trajnim dhe Arsim, si dhe fazën e ardhshme të Procesit të Bolonjës.

Pas hulumtimeve fillestare në zyre dhe anketës të kryera nga organizatat anëtare të EI dhe ESU (unionet e stafit të arsimit të lartë dhe unionet kombëtare të studentëve), të botuara në maj 2010, ky material është një nga nismat e fundit, duke shënuar fazën e përfundimit të projektit dhe paraqet rezultatin kyç të projektit. Ky material bazohet në hulumtimet e gjëra dhe në një seri të ngjarjeve në nivelet evropiane dhe kombëtare, i kombinuar me trajnime për lëndën.

Kjo paketë e mjeteve është dizajnuar për zbatimin efektiv dhe praktik të SCL-së nga stafi mësimor, nxënësit dhe udhëheqësit institucional. Ajo ka për qëllim të tregojë se sa praktike dhe e arritshme SCL-ja është, si dhe është shumë e dobishme për studentët.

1.2 KONCEPTI I SCL-së

Një pjesë e SCL-së i atribuohet Hayward-it që nga viti 1905 dhe punës së Dewey-it në vitin 1956. Kurse, Carl Rogers në atë kohë ishte i ngarkuar me zgjerimin e kësaj qasjeje në një teori të arsimit në vitet 1980 dhe kjo qasje e mësimnxënies ka qenë gjithashtu e lidhur me punën e Piaget-it (të mësuarit zhvillimor) dhe Knowles Malcolm (të mësuarit e vetë-drejtuar). Një pjesë e literaturës së SCL-së mund të përmblihet në elementët e mëposhtme (cf. Lea et al, 2003):

- ◊ Mbështetja në të mësuarit aktiv se sa pasiv;
- ◊ Theksi mbi të mësuarit dhe të kuptuarit e thellë;
- ◊ Rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies nga ana e studentit;
- ◊ Kuptim i rritur i autonomisë në studentin;
- ◊ Ndërvlerësia midis mësimit dhe studentit;
- ◊ Respekt të ndërsjellë në marrëdhëniet student- mësimit; dhe
- ◊ Një qasje refleksive në procesin e mësimit dhe të mësuarit nga ana e mësimit dhe studentit.

SCL është e bazuar gjerësisht në konstruktivizëm si një teori e të mësuarit, e cila bazohet mbi idenë se studentët duhet të ndërtojnë dhe të rindërtojnë dijen në mënyrë që të mësojnë në mënyrë efektive, duke qenë mësimi më së shumti efektiv atëherë kur, si pjesë e një aktiviteti, studenti e përjeton konstruktimin si një produkt kuptimplotë. SCL-ja është gjithashtu e ngjashme me të mësuarit transformues i cili parashikon një proces të ndryshimit cilësor të studentit si një proces i vazhdueshëm i transformimit, që fokusohet në rritjen dhe fuqizimin e studentëve, si dhe në zhvillimin e aftësisë kritike të tyre.

1.3 Parimet themelore të SCL-së

Në bazë të një studimi të teorisë së SCL-së dhe pas një diskutimi intensiv me mësimit dhe studentët lidhur me atë se çfarë e konsiderojnë ata SCL-në, që u zhvillua në konferencën e lansimit të Projektit T4SCL - Koha për një paradigëm të re në arsim: Të mësuarit me studentin në qendër - në Bukuresht, Rumani në muajin maj 2010, më poshtë është dhënë lista e parimeve të përgjithshme në të cilat mbështetet SCL. Këto parime nuk kanë për qëllim të formojnë një tablo gjithëpërfshirëse lidhur me atë se çfarë është SCL-ja. Përkundrazi, ato paraqesin një kuptim të qartë dhe debat në lidhje me temën.

- **Parimi I: SCL kërkon një proces të vazhdueshëm reflektiv.** Një pjesë e filozofisë themelore të SCL-së është ajo se asnjë kontekst nuk mund të ketë një stil të SCL-së që mund të jetë i aplikueshëm për një kohë të gjatë. Filozofia e SCL-së është e tillë që mësimit, studentët dhe institucionet duhet të reflektojnë në mënyrë të vazhdueshme sistemet e mësimit, mësuesit dhe infrastrukturën e tyre në mënyrë të tillë që të përmirësojnë në mënyrë të vazhdueshme përvojën e studentëve për të mësuarit dhe të sigurojnë që rezultatet e synuara të mësuarit të një kursi ose komponenti të caktuar të programit janë arritur në një mënyrë që stimulon mendimin kritik të studentëve dhe aftësitë e transferueshme.
- **Parimi II: SCL nuk ka një zgjidhje që iu përshtatet të gjitha problemeve.** Koncepti kyç në të cilat bazohet SCL është të kuptuarit se të gjitha institucionet e arsimit të lartë janë të ndryshme, të gjithë mësimit janë të ndryshëm dhe të gjithë studentët janë të ndryshëm. Të gjithë këta funksionojnë në kontekste shumë të ndryshme dhe merren me disiplina të ndryshme. Prandaj SCL-ja është një qasje e të mësuarit që kërkon të ketë struktura mbështetëse për mësuesit të cilat janë të përshtatshme për çdo kontekst të caktuar, si dhe stile të mësimit dhe të mësimit të përshtatshme për ata që i ndërmarrin ato.
- **Parimi III: Studentët kanë stile të ndryshme të të mësuarit.** SCL pranon se studentët kanë nevoja të ndryshme pedagogjike. Disa mësojnë më mirë përmes punës dhe gabimeve, të tjerët mësojnë nga përvoja praktike. Disa nxënës më shumë mësojnë duke lexuar literaturë, të tjerët kanë nevojë për të debatuar dhe për të diskutuar teorinë në mënyrë që ta kuptojnë atë.
- **Parimi IV: Studentët kanë nevoja dhe interesa të ndryshëm.** Të gjithë studentët kanë nevoja që shtrihen përtej klasës. Disa janë të interesuar në aktivitete kulturore, të tjerët në sport apo në organizata përfaqësuese. Studentët mund të kenë fëmijë ose mund të përballen me kushte psikologjike, sëmundje ose aftësi të kufizuara.
- **Parimi V: Zgjedhja është pikë qendrore për të mësuarit efektiv në SCL.** Studentëve u pëlqen të mësojnë gjëra të ndryshme dhe kështu çdo ofertë duhet të përfshijë një numër të arsyeshëm të zgjedhjes. Të mësuarit mund të organizohet në formate liberale, si në kolegjet e arteve liberale ose zgjedhja mund të ofrohet në një stil më tradicional, disiplinor.
- **Parimi VI: Studentët kanë përvoja dhe njohuri paraprake të ndryshme.** Mësuesit duhet të përshtatet me jetën dhe përvojën profesionale të individit në fjalë. Për shembull, në qoftë se studentët tashmë kanë përvojë të konsiderueshme në përdorimin e TIK-ut, nuk ka kuptim që të bëjmë përpjekje për t'iu mësuar atyre të njëjtën gjë përsëri; nëse ata tashmë kanë aftësi të konsiderueshme hulumtuese, ndoshta do të ishte më mirë për t'i ndihmuar ata në teori.

Përvojapersonale mund të përdoret gjithashtu për t' i motivuar studentët, përshebull, duke iu mundësuar studentëve të ndajnë një histori personale për të ilustruar një pikë.

- **Parimi VII: Studentët duhet të kenë kontroll mbi të mësuarit e tyre.** Studentëve duhet t'iu jepet mundësia për t'u përfshirë në hartimin e kurseve, kurrikulave dhe vlerësimin e tyre. Studentët duhet të shihen si partnerë aktivë të cilët kanë interes në mënyrën se si funksionon arsimi i lartë. Mënyra më e mirë për të siguruar se të mësuarit fokusohet më shumë në studentët është duke i angazhuar vetë studentët se si duhet formësuar të mësuarit e tyre.
- **Parimi VIII: SCL ka të bëjë me “të mundësuarit” e jo ‘të rrëfyerit’.** Thjeshtë në bartjen e fakteve dhe njohurive tek studentët (të rrëfyerit), iniciativa, përgatitja dhe përmbajtja vijnë kryesisht nga mësimdhënësi. Qasja e SCL-së synon t' i japë studentit përgjegjësi më të madhe duke bërë të mundur që studenti të mendojë, procesojë, analizojë, sintetizojë, kritikojë, aplikojë, të zgjidh probleme, etj.
- **Parimi IX: Mësimnxënia ka nevojë për bashkëpunim ndërmjet studentëve dhe stafit.** Është e rëndësishme që studentët dhe stafi të bashkëpunojnë për të zhvilluar të kuptuarit e përbashkët për problemet e hasura gjatë të mësuarit, si dhe problemet e tyre si hisedarë brenda institucionit të tyre përkatës, duke propozuar së bashku zgjidhjet që mund të funksionojnë për të dy grupet. Në klasë, bashkëpunimi i tillë do të ketë një efekt pozitiv, pasi që të dy grupet gjithnjë e më shumë vijnë në atë pikë ku e konsiderojnë njëri-tjetrin si partnerë. Një partneritet i tillë është pikë qendrore e filozofisë së SCL-së e cila e cilëson se të mësuarit është një ndërveprim konstruktiv ndërmjet dy grupeve.

1.4 PËRKUFIZIMI I REALIZUESHËM I SCL-së

SCL-ja mbetet një koncept i debatuar pa ndonjë përkufizim të qartë në dispozicion, pasi që bashkë- ekzistojnë interpretime të shumta të cilat përjashtojnë njëra-tjetrën. Megjithatë, ky seksion do të përpiqet për ta anashkaluar këtë çështje duke arritur në një përkufizim të zbatueshëm për SCL-në.

Është interesante që së pari të shohim se çfarë kanë shqyrtuar pjesëmarrësit në konferencën e lansimit të Projektit T4SCL si komponentë integrale të SCL-së. Këto përfshijnë

- Fleksibilitetin dhe lirinë në aspektin e kohës dhe strukturës së të mësuarit;
- Më shumë mësimdhënës dhe më cilësor të cilët përpiqen të shkëmbejnë njohuritë e tyre;
- Të kuptuarit e qartë të studentëve nga mësimdhënësit;

- Hierarki e sheshtë brenda institucioneve të arsimit të lartë;
- Përgjegjësia e mësimitdhënësit për fuqizimin e studentit;
- Një proces i vazhdueshëm i përmirësimit;
- Qëndrim pozitiv nga mësimitdhënësit dhe studentët me qëllim të përmirësimit të përvojës së të mësuarit;
- Një marrëdhënie e këmbëngulësisë së ndërsjellë ndërmjet studentëve dhe mësimitdhënësve; dhe
- Fokusi në rezultatet e të mësuarit të cilat mundësojnë të mësuarit e vërtetë dhe të kuptuarit e thellë.

Në bazë të të gjitha këtyre elementeve që u thanë më lartë dhe sipas sugjerimeve praktike të parashtruara më poshtë, ky material propozon përkufizimin e mëposhtëm të SCL-së:

Të Mësuarit me Studentin në Qendër paraqet të menduarit dhe një kulturë brenda një institucioni të caktuar të arsimit të lartë dhe është një qasje e të mësuarit që lidhet gjerësisht me të, si dhe është e mbështetur nga teoritë konstruktive të të mësuarit. Ajo karakterizohet nga metodat inovative të mësimitdhënies të cilat synojnë të promovojnë të mësuarit në komunikim me mësimitdhënësit dhe studentët e tjerë dhe që i sheh studentët seriozisht si pjesëmarrës aktiv në procesin e tyre të të mësuarit, duke nxitur aftësi të transferueshme të tilla si zgjidhja e problemeve, mendimi kritik dhe të menduarit reflektiv.

Duke e përdorur këtë përkufizim si pikënisje e dobishme fillestare, kjo paketë e mjeteve tani do të shkojë tutje për të sugjeruar mënyrat praktike në të cilat mund të zbatohet SCL-ja në mënyrë kuptimplotë, duke marrë parasysh përfitimet që dalin nga kjo qasje e të mësuarit dhe karakteristikat kryesore të cilat janë të nevojshme për një institucion që të vlerësojë nëse qasja e SCL-së është duke u zbatuar nga ai.



2 PËRFITIMET

2.1 HYRJE

SCL-ja, nëse zbatohet siç duhet, ofron përfitime për të gjithë, duke përfshirë edhe institucionin, studentët dhe stafin e përfshirë, sindikatat e stafit të arsimit të lartë, unionet e studentëve dhe shoqërinë në tërësi. Duke pasur parasysh kontekstin aktual të arsimit të lartë në Evropë - gjendjen financiare, masivizimin e arsimit të lartë dhe një ngarkesë të lartë për mësimdhënësit - ka shumë përfitime të cilat mund të arrihen duke zbatuar qasjen e SCL-së.


2.2 PËRFITIMET PËR STUDENTËT

Përfitimet e SCL-së për studentët e përfshirë janë të shumta dhe të ndryshme. Duke ardhur në kontakt me një komunitet akademik, ndoshta për herë të parë, mund të formësojnë mënyrën se si mendojnë studentët për pjesën tjetër të jetës së tyre. SCL-ja ofron shkathësitë për jetë, krijon studentë të pavarur dhe iu përgjigjet nevojave në ndryshim dhe të dalueshme të studentëve individual. Më poshtë është dhënë një listë e përfitimeve të tilla të cilat mund të përfshijnë si vijon:

- **Integrimi i studentëve si pjesë përbërëse e komunitetit akademik:** Thuhet se studentët janë pjesë e komunitetit akademik, por në praktikë kjo mund të jetë vështirë e arritshme për shkak të praktikave të ndryshme të strukturave të ngurta të mësimdhënies. Nëpërmjet SCL-së, studentët mund të bëhen pjesë e atij komuniteti shumë më herët, duke qenë se mësimdhënësi vepron si një lehtësues, dhe jo një instruktor. Në nxitjen e studentëve që të mendojnë për veten e tyre, aftësitë analitike dhe mendimi kritik fitohen më herët. Në këtë kontekst, të mësuarit nga hulumtimet bëhet edhe më i mundshëm. Mësimdhënësit janë në gjendje të diskutojnë hulumtimet e tyre dhe të dëgjojnë pikëpamjet e studentëve lidhur me çështjen. Bashkëpunimi i rritur dhe ndjenja se pikëpamjet janë të vlerësuara nga të tjerët mund të rrisë më tej ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve. Kjo mund të çojë deri tek pjesëmarrja në zhvillimin e hulumtimit dhe gjithashtu të ndihmojë në zhvillimin e një kursi të caktuar, për shkak të ndjenjës së pronësisë të cilën e fitojnë studentët. Së fundi, ajo gjithashtu mund të inkurajojë më shumë studentë për të hyrë në komunitetin akademik si anëtarë. Ne nuk duhet të harrojmë se studentët janë mësimdhënësit e së ardhmes!

fig. 1 Piramida e të mësuarit

Burimi: Laboratorët e Trajnimeve Kombëtare, Bethel, Maine



- **Motivimi i rritur për të mësuar:** SCL-ja mund të nxisë të mësuarit më të thellë, siç tregohet në Piramidën e të Mësuarit më poshtë. Mbajtja e njohurive ndryshon në varësi të mënyrës sipas së cilës materiali është mësuar, por të gjitha llojet e të mësuarit aktiv tregojnë një normë më të lartë sesa format tradicionale të të mësuarit. Studenti është shpesh edhe më i motivuar për të mësuar nëpërmjet SCL-së, sepse detyrat e dhëna kërkojnë mendim origjinal dhe interesim të rritur lidhur me lëndën. Ashtu siç sugjeron Piramida e të Mësuarit më poshtë, studentët marrin më shumë informata nga ato që i mësojnë aty ku ekziston aspekti i të mësuarit aktiv dhe pjesëmarrjes aktive.
- **Pavarësia dhe përgjegjësia në mësimnxënie:** Në kuadër të SCL-së, studentët duhet të përdorin materialet e lëndës së caktuar dhe të kanë në kontroll procesin e mësimnxënies. Kjo e bën studentin më të pavarur dhe të adaptueshëm në jetë pas arsimit të lartë. Pavarësia e studentëve u mundëson atyre të mësojnë me më shumë efektivitet dhe të fitojnë aftësi të tjera siç janë puna ekipore, komunikimi efektiv me shkrim dhe me gojë, prioritizimi i detyrave dhe analiza kritike. Nga ana tjetër, studentët mund të zhvillojnë aftësi të transferueshme dhe të jenë në gjendje të punojnë në mënyrë më efektive në karrierën e tyre dhe jetën në përgjithësi.

- **Konsideratë e duhur ndaj nevojave të studentit:** Masivizimi i arsimit të lartë ka pasur efektin e diversifikimit të strukturës së studentëve. Në mënyrë të pashmangshme studentët kanë nevoja të ndryshme të cilat janë më të mëdha se kurrë më parë. SCL-ja mund t'iu mundësojë studentëve të studiojnë në mënyrë fleksibile, nëpërmjet përdorimit të studimeve me orar të përgjysmuar, studimit në distancë dhe mësimin elektronik. Qasja e SCL-së tregon se të mësuarit nuk kufizohet në një kohë apo vend të caktuar, ashtu siç ka qenë të mësuarit tradicional. Nevojat e ndryshme të të mësuarit për studentët gjithashtu mund të realizohen, sepse studentët mund të marrin materialet në mënyra të ndryshme. Për shembull, disa studentë përdorin më shumë materialet audiovizuale, ndërsa të tjerë preferojnë leximin. Për më tepër, duke përjetuar një varg të metodave të mësimdhënies studentët sfidohen më tej në aspektin akademik.

2.3 PËRFITIMET PËR MËSIMDHËNËSIT

Përderisa përfitimet që ofron SCL-ja për studentët janë të dukshme, mund të shtrohet pyetja nëse kjo vlen edhe për personelin mësimor. Në të vërtetë, mësimdhënësit, mund të përfitojnë nga SCL-ja po aq sa studentët në klasat e tyre. Më poshtë është dhënë një listë se çfarë mund të përfshijnë përfitimet e tilla:

- **Rol më interesant për mësimdhënësin:** SCL-ja, siç u cek më lart, vë theksin mbi studentët për të mësuar. Mësimdhënësi është atje për të lehtësuar dhe për të mundësuar këtë proces. Përderisa kjo mund të shihet nga disa si negative, kjo është një mundësi e mirë për të sfiduar studentët në mënyrë akademike, më qëllim të rritjes së nivelit të të mësuarit të tyre.
- **Zgjidhjet për adresuar masivizimin dhe diversitetin:** Në një realitet të masivizimit në arsimin e lartë dhe në një strukturë më të larmishme të studentëve, ka të ngjarë që SCL-ja do të duhet të përdoret në shumë raste për shkak të kërkesave në rritje për cilësi nga studentët, kostot në rritje të arsimit të lartë lidhur me këtë dhe diversitetin e strukturës së studentëve, që do të thotë se nevojat e studentëve janë të ndryshme.
- **Ndikim pozitiv në kushtet e punës.** Duke pasur parasysh se SCL-ja ofron mundësinë që të mësuarit të bëhet në mënyra të ndryshme, puna e një mësimdhënësi mund të jetë më interesante dhe aspektet negative të kushteve të punës të shoqëruara zakonisht me mësimdhënien mund të lehtësohen nga SCL-ja.

- **Vetë-përmirësim i vazhdueshëm:** SCL mund të ju mundësojë mësimdhënësve rishikimin dhe zhvillimin e kurseve të tyre dhe metodave të mësimdhënies, në mënyrë që të përmirësojë përmbajtjen e kurseve të tyre dhe metodologjinë e tyre të mësimdhënies. Besimi i fituar nga zbatimi i qasjes së SCL-së është gjithashtu i matshëm për shkak se mësimdhënësit marrin reagime kthyese të rëndësishme dhe konstruktive nga studentët që janë shumë të angazhuar.
- **Motivimi dhe angazhimi i rritur i studentëve:** Rritja e angazhimit nga ana e studentëve dhe një nivel më i lartë i pjesëmarrjes së studentëve e bën punën e mësimdhënies të jetë më interesante. Aftësia për të sjellë hulumtime të reja tek tutorët apo klasat bëhet një realitet në SCL. Ky grup i mirëfilltë e ideove mund të kontribuojë në hulumtimin e mësimdhëniesit dhe t'i sjellë studentët pranë komunitetit akademik dhe hulumtimeve në një fazë të hershme në procesin e tyre të mësimnxënies.
- **Zhvillimi profesional për nivelin akademik:** SCL-ja mund të ofrojë një nivel shumë më të lartë të zhvillimit profesional në lidhje me zhvillimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave relevante për zhvillimin personal dhe përparimin në karrierë. Ajo gjithashtu rrit fleksibilitetin e mësimdhënësve në hartimin e mënyrave për drejtimin e kursit (lëndës) ose një komponenti të programit, si dhe në aplikimin e mënyrave të reja të mësimdhënies ose hulumtimeve.

2.4 PËRFITIME TË TJËRA NGA SCL

Si stafi mësimdhënës ashtu edhe studentët kanë interes dhe përfitim nga SCL-ja. Kjo prodhon pika të përbashkëta dhe përfitime për organizatat e tyre përfaqësuese. Më poshtë është dhënë një listë me përfitimet që mund të përfshihen:

- **Rritja e cilësisë:** Çdo rritje në cilësi e kushteve të punës dhe përvojës akademike të studentit do të mirëpritet nga sindikatat e mësimdhënësve dhe unionet e studentëve.
- **Statusi i profesionit të mësimdhëniesit:** Duke pasur parasysh trendin e fokusimit të institucioneve në hulumtime, statusi i profesionit të mësimdhënies mund të përmirësohet me adaptimin e qasjes së SCL-së. SCL-ja merr parasysh inovacionin dhe iu mundëson mësimdhënësve të zhvillojnë kurset e tyre sipas mënyrës që ata dëshirojnë, ndërkohë që iu mundëson studentëve të zhvillojnë fleksibilitetin sipas mënyrës së tyre.
- **Rritja e përfaqësimit në strukturat e qeverisjes:** Duke pasur parasysh se SCL-ja kërkon një nivel më të lartë të bashkëpunimit mes të gjitha niveleve institucionale, kjo supozon që hierarkia brenda institucioneve të arsimit të lartë është mjaft e sheshtë.

SCL pra favorizon një qëndrim më bashkëpunues brenda institucioneve, duke mundësuar përfaqësim më të madh të studentëve dhe stafit brenda strukturave përkatëse të qeverisjes.

SCL gjithashtu prodhon përfitime si për institucionet në të cilat qasja e të mësuarit është duke u aplikuar, po ashtu edhe për shoqërinë, e cila është përfutuesi kryesor i të diplomuarve të cilët janë kreativ, mendimtarë kritik dhe reflektues, si dhe të cilët janë në gjendje të çojnë përpara zhvillimin në shoqërinë ku ata jetojnë. Më poshtë është dhënë një listë se çfarë mund të përfshijnë përfitimet e tilla:

- **Nivele më të mira të numrit të studentëve në arsimin e lartë:** Aty ku institucionet përdorin qasjen e SCL-së, ka tendencë që numri i studentëve të cilët vendosin të mos i përfundojnë studimet e tyre të jetë më i ulët. Kjo mund të jetë për shkak të fleksibilitetit në kurse të tilla dhe mund të jetë për shkak të faktit se, me anë të SCL-së, studentët angazhohen më shumë në studimet e tyre se në metodat tradicionale të të mësuarit. Në të vërtetë, studentët ndjehen më të vlerësuar kur mësojnë në një ambient të SCL-së ngase nevojat e tyre të të mësuarit janë mbizotëruese. Në një klimë të masivizimit, formalizimit dhe anonimitetit të arsimit të lartë, kjo vetëm se mund të jetë e mirëpritur.
- **Tërheqja e studentëve:** Aty ku nevojat e të mësuarit të studentëve janë shqyrtuar me kujdes, mësimi do të konsiderohet të jetë i cilësisë më të lartë. Përmeshja e pritjeve të studentëve dhe menaxhimi i tyre është i një rëndësie të madhe. Për më tepër, shumë aspekte të SCL-së mund të zbatohen pa masa të kushtueshme dhe ato institucione të cilat zbatojnë këtë qasje mund të jenë shumë më tërheqëse për studentët potencialë, gjithashtu duke tërhequr më shumë lëvizshmëri në rajonin ku gjendet edhe institucioni, pra duke përfutur nga kjo edhe zhvillimi i shoqërisë.
- **Një proces i vazhdueshëm i përmirësimit:** Aftësia e institucioneve për të vlerësuar kurset e tyre dhe përvojën akademike të studentëve si një tërësi do të thotë se ata prodhojnë të diplomuar më të mirë. Përfitimi kryesor për shoqërinë në tërësi është që të diplomuarit e tillë janë më analitik dhe qytetarë më të mirë dhe, si rezultat, ata mendojnë për veten e tyre gjatë tërë kësaj të studimeve të tyre të arsimit të lartë.
- **Nxitja e një kulture për të mësuarit gjatë gjithë jetës:** Studentët të cilët kanë përjetuar SCL-në kanë më shumë gjasa për të mësuar vetë mësimet dhe ekziston mundësia që ata të jenë më praktikë dhe logjik, me një aftësi për të trajtuar të gjitha llojet e problemeve posa shfaqen ato, duke e kthyer këtë në një përvojë mësimi. SCL-ja mund t'iu jap shkathësi të diplomuarve për të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke i bërë ata më efektiv në vendin e tyre të punës dhe duke u mundësuar atyre të kontribuojnë gjerësisht në shoqërinë ku ata jetojnë.



3 LISTA VERIFIKUESE E SCL-së

Ky kapitull i paketës së mjeteve ofron një listë verifikuese indikative të asaj se çfarë mund të kërkohet në aspektin e zbatimit të suksesshëm të qasjes së SCL-së:

- Nëse dikush vëren se në institucionin e tyre vetëm disa apo asnjë nga elementet e përmendura më poshtë janë të pranishme, atëherë kapitujt vijues do të jenë të dobishëm për të ndihmuar në identifikimin e mënyrës në të cilën mund të aplikohet SCL-ja. Në veçanti, Kapitulli 4 ka të bëjë me atë se si mund të ndodhë ndryshimi në mënyrë që të shkojmë drejt zbatimit të qasjes së SCL-së.
- Nëse, nga ana tjetër, shihet se shumica e elementeve të përmendura më poshtë janë të pranishme në institucionin e tyre, atëherë ky është një indikacion se institucioni është në rrugën e duhur, por do të ishte e dobishme të konsultohen kapitujt vijues në çdo rast, duke qenë se SCL-ja na mëson që të kërkojmë përmirësimin e metodave aktualisht të aplikueshme.

1. Konsultimet me studentë		Po	Jo
1.1	A ka procedura transparente për studentët në mënyrë që ata të jenë në gjendje të japin mendimin e tyre për cilësinë e procesit arsimor?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
1.2	A konsultohen studentët lidhur me përbajtjen e planprogrameve mësimore?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
1.3	A konsultohen studentët lidhur me metodat e përdorura të mësimdhënies dhe të vlerësimit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
1.4	A janë të përfshirë studentët në rishikimet periodike të cilësisë së programit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
1.5	A janë të përfshirë studentët si anëtarë të plotë dhe të barabartë në komisione, ku diskutohen çështjet që lidhen me përvojën e studentit në të gjitha nivelet (p.sh. departamenti, fakulteti, universiteti, etj.)?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
1.6	A ka procedura të qarta për studentët që të apelojnë vendimet në lidhje me arritjen e tyre akademike ose progresin?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

2. ECTS (Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve) dhe Rezultatet e të Mësuarit		Po	Jo
2.1	A konsultohen studentët me rastin e dizajnit të rezultateve të të mësuarit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2.2	A merren parasysh nevojat dhe diversiteti i grupit përkatës të studentëve me rastin e dizajnit të rezultateve të të nxënës?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2.3	A janë të informuar studentët lidhur me rezultatet e synuara të të mësuarit para se të fillojë një kurs ose komponent i programit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2.4	A janë përdorur kreditë ECTS të ndërlidhura me rezultatet e përcaktuara të të mësuarit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2.5	A janë të transferueshme kreditë ndërmjet kurseve dhe institucioneve?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2.6	A janë të matshme kreditë bazuar në vëllimin e punës së studentit, pavarësisht nga numri i orëve të kontaktit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2.7	A iu ndihmojnë kreditë e dhëna lidhur me aktivitetet e studentëve që t'i arrijnë rezultatet e synuara për të mësuarit në qoftë se kryhen jashtë institucionit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2.8	A i referon institucioni i juaj kualifikimet e tij sipas Kornizës së Kualifikimeve?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

3. Sigurimi i Cilësisë		Po	Jo
3.1	A janë konsultuar stafi dhe studentët gjatë procesit institucional të sigurimit të cilësisë?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
3.2	A janë të përfshirë përfaqësuesit e mësimdhënësve dhe të studentëve si anëtarë të plotë dhe të barabartë në panelet që kryejnë rishikimet institucionale të sigurimit të cilësisë?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
3.3	A merren parasysh udhëzimet dhe elementet e përgjithshme të mësimdhënies dhe të mësimnxënies në rishikimet institucionale të sigurimit të cilësisë?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
3.4	A merret parasysh përdorimi i rezultateve të të mësuarit në rishikimet e cilësisë së programit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
3.5	A merren parasysh metodat e përdorura të vlerësimit në rishikimet e cilësisë së programit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
3.6	A i referohet procesi i mësimdhënies dhe të mësuarit vlerësimeve të jashtme të sigurimit të cilësisë?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

4. Mobiliteti, njohja dhe të mësuarit e mëparshëm		Po	Jo
4.1	A realizohen periudha të studimeve nga studentët në institucionet e tjera në kuadër të skemave të ndryshme të mobilitetit që njihen nga institucioni juaj?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
4.2	A përfitojnë studentët vizitues mobil nga mbështetja e institucionit tuaj, në mënyrë që të jenë në gjendje për të përballuar mjedisin e ri gjuhësor dhe kulturor?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
4.3	A diskutohen dhe shpërndahen në nivel institucional shembujt e praktikave të mira në mësimdhënie dhe mësimnxënie me të cilat stafi mobil bie në kontakt?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
4.4	A njihet nga institucioni i juaj të mësuarit e mëparshëm (në mjediset jo-formale të të mësuarit) me qëllim të qasjes në programet arsimore?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
4.5	A është i ndërlikuar procesi i njohjes së të mësuarit të mëparshëm?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
4.6	A përfshin njohja e të mësuarit të mëparshëm kosto të mëdha apo procedura burokratike?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

5. Dimensiooni social		Po	Jo
5.1	A ekzistojnë masa të veçanta mbështetëse në mënyrë që të ndihmojnë studentët që kanë prapavijetë pafavorizuar?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
5.2	A janë fleksibile metodat e të mësuarit në mënyrë që të lejojnë kombinimin e studimeve me punë/jetën familjare?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

6. Metodat e mësimdhënies dhe të mësimnxënies		Po	Jo
6.1	A përdor institucioni i juaj vlerësimin nga kolegët dhe të mësuarit me kolegët?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
6.2	A ka institucioni juaj programe për të cilat përdor të mësuarit e bazuar në aktivitete?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
6.3	A përdoret puna në grupe në procesin e të mësuarit në institucionin tuaj?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
6.4	A pranohen dhe njihen aktivitetet ekstra-kurrikulare të studentëve si pjesë thelbësore e përvojës së të mësuarit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
6.5	A është zhvillimi i aftësive transversale nga studentët një nga objektivat e procesit të të mësuarit në institucionin tuaj?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

7. Metodat e vlerësimit të studentëve		Po	Jo
7.1	A përcaktohen qëllimet e procesit mësimor ndërmjet mësimdhënësve dhe studentëve?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
7.2	A përdoret vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga kolegët si metodë në procesin e vlerësimit të studentëve?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
7.3	A përdoren projektet në vlerësimin e studentëve?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
7.4	A përdoren simulimet e detyrave dhe situata nga "jeta reale" në vlerësimin e studentëve?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

8. Mjedisi i të mësuarit		Po	Jo
8.1	A kanë qasje studentët në hapësirat adekuate të studimit dhe hulumtimeve brenda dhe jashtë kampusit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
8.2	A përdoret Teknologjia Informative në procesin e të mësuarit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
8.3	A bashkëpunojnë bibliotekarët me mësimdhënësit, me qëllim të rritjes së përvojës të të mësuarit për studentët?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
8.4	A kontribuon institucioni i juaj në promovimin e një kulture kombëtare/ rajonale të SCL-së?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

9. Zhvillimi Profesional Akademik		Po	Jo
9.1	A ka institucioni juaj ndonjë udhëzues lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
9.2	A ka institucioni juaj program të rregullt të zhvillimit profesional për stafin ligjërues?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
9.3	Nëse po, a përfshin ky program diskutime konstruktive mbi aplikimin e metodave të mësimdhënies?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
9.4	A përdor ky program qasjen e SCL-së në ofrimin e trajnimeve për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe zhvillimin e kurrikulës me të mësuarit me studentin në qendër?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

4. NDRYSHIMI I TË MENDUARIT

4.1 HYRJE

Aty ku asnjë ose vetëm disa nga elementet e listuara në listën verifikuese të mësipërme janë të pranishme brenda një institucioni të caktuar të arsimit të lartë, do të duhej të iniciohej një proces i ndryshimit me qëllim që në sistemin ose institucionin e arsimit të lartë të nis zbatimin e qasjes së SCL-së. Në mënyrë që ndryshimi të ndodhë në një mjedis të caktuar të arsimit të lartë, është e nevojshme që të ekzistojë një strategji me qëllim të bashkëpunimit me të tjerët dhe bindjes së tyre. Bashkëpunimi në mes të kolegëve është vlerë qendrore në arsimin e lartë. Një Strategji e bazuar në shtrëngim dhe fuqi jo vetëm që do të dështojë, por edhe do të rris kundërshtimin aktiv. Strategjitë duhet që gjithmonë të bazohen në vlera të tilla si liria akademike dhe profesionalizmi në qoftë se dëshirojnë të arrijnë rezultate të prekshme. Sfida qenron në krijimin e një koalicioni me ata që duan të ndryshojnë dhe për të bindur të tjerët që janë skeptikë. Më poshtë, janë dhënë disa udhëzime për të elaboruar planet e reformimit. Kapitulli do të vazhdojë në gjashtë hapa në një cikël kreativ të politikave, duke filluar me planifikimin dhe duke përfunduar me vlerësimin e procesit të ndryshimit, me qëllim të zbatimit të reformave që çojnë në zbatimin e suksesshëm të qasjes së SCL-së.

4.2 CIKLI I POLITIKAVE

Shumë debate ekzistojnë sa iu përket politikave të arsimit të lartë në pyetjen se a është ndryshimi më efektiv sipas qasjes nga lart-poshtë ose nga poshtë-lart. Ekzistojnë argumente të fuqishme në të dy anët e debatit. Mbështetësit e qasjes nga lart-poshtë thonë se udhëheqësit e zgjedhur në mënyrë demokratike në arsimin e lartë duhet të kontrollojnë burimet për të zbatuar një politikë të qëndrueshme në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit të lartë. Metodat nga lart-poshtë të tilla si ligjet, rregulloret, dekretet ministrore, misionet institucionale dhe agjendat e reformës mund të garantojnë qëndrueshmëri në një mjedis të caktuar të arsimit të lartë. Ithtarët e qasjes nga poshtë-lart argumentojnë se nuk mund të ndodh asnjë lloj ndryshimi nëse kryhet pa përkrahjen e atyre që do të merren me mësimdhënien aktuale, ndërsa ajo do të jetë më efektive nëse iniciativat fillojnë me vetë individët dhe përhapen me anë të një procesi të frymëzimit dhe shkëmbimit të praktikave të mira.

Në përpjekje për të bërë ndryshimet që çojnë drejt adaptimit të qasjes së SCL-së, është e këshillueshme që të jemi pragmatik dhe mënyra e hartimit të politikave të jetë gjithëpërfshirëse. Në një vizion pragmatik, si nivelet e larta ashtu edhe ato të poshtmet luajnë role të ndryshme dhe nuk duhet të mbitheksohen. Udhëheqësit e arsimit të lartë janë të nevojshëm, sepse ata kanë qasje në burime dhe në personel, si dhe kanë një pasqyrë të mirë të sistemit.

Nga ana tjetër, nivelet e ulëta kanë ekspertizën në terren. Ata gjithashtu kanë edhe ide inovative dhe ofrojnë motivimin për të zbatuar politikat e dhëna. Një cikël i mirë i politikave e njih rolin e të dy niveleve dhe ka për qëllim t'iu mundësojë bashkëpunimin.

Cikli i politikave pranon se politikëbërja ndodhë në hapa interaktiv të cilët nuk mund të planifikohen plotësisht nga fillimi. Nëse paraqiten në një model, kjo mund të duket si më poshtë:

fig. 2 Cikli i politikave në gjashtë hapa



4.3 HAPI I PARË: ANALIZA E PROBLEMIT

Shumë strategji dështojnë që në nivelin bazik, pasi që reformatorët në të vërtetë nuk e dinë se çfarë dëshirojnë të ndryshojnë. Hapi i parë gjithmonë duhet të jetë analiza e plotë e situatës aktuale dhe skicimi i problemit ekzistues. Edhe pse shkalla dhe detajet për të cilat mund të aplikohet pika e fundit do të ndryshojnë nga një situatë në tjetrën, është e dobishme që të mendohet qartë se çfarë është problemi kryesor dhe për të parë nëse të kuptuarit e problemit është ndarë me kolegët dhe hisedarët e tjerë në kuadër të një komuniteti të caktuar të arsimit të lartë. Edhe në qoftë se është e qartë se jo çdo gjithçka mund të planifikohet, duhet të vendosen objektiva të qarta dhe një afat kohor për të arritur ndryshimin e synuar.

Ju gjithashtu mund të provoni të parashtroni një numër pyetjesh:

- Sa nga elementet e listës verifikuese të përmendur më lart janë të pranishme?
- Si e përkufizoni SCL-në?
- Si është mjedisi i juaj i arsimit të lartë ku nuk punon sipas qasjes me studentin në qendër?
- Çfarë është bërë deri më tanipër të zgjidhur problemin?
- Deri në çfarë mase kanë qenë të suksesshme këto përpjekje ose pse nuk kanë qenë të suksesshme?
- Kush dhe çfarë duhet të ndryshojë?
- Cilat kompetenca dhe burime janë të nevojshme për të zgjidhur problemin?

Një mjet i dobishëm në këtë fazë të parë është analiza SWOT, duke përfshirë listën e mëposhtme:

- Përparësitë
- Dobësitë
- Mundësitë dhe
- Kërcënimet

të situatës aktuale, si bazë për ta ndryshuar atë.

Analiza e problemit është shumë e lidhur me të menduarit për zgjidhjet. Kjo fazë përfshin të menduarit për zgjidhje kreative dhe strategjitë për të adresuar problemin në mënyrë pro-aktive. Në mënyrë që të mos bllokohemi në zgjidhje të thjeshtë, më së miri është të gjenerojmë ide të ndryshme për t'u marrë me këtë problem dhe t'i vlerësojmë ato kundrejt njëra-tjetrës vetëm pasi që të dalim me disa mundësi për veprim. Kjo nuk do të pengojë kreativitetin në zhvillimin e zgjidhjeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për SCL-në pasi që ajo si e tillë është një koncept i gjerë. Zgjidhjet mund të përfshijnë konsideratat lidhur me pedagogjinë, pjesëmarrjen e studentëve apo çështjet më të gjera sociale të lidhura me përvojën e studentit.

Në një fazë të hershme, është e rëndësishme që të jemi të vetëdijshëm se trendi i tanishëm në bërjen e politikave është politikëbëja e bazuar në dëshmi.

Me pak fjalë, kjo do të thotë se argumentet dhe idetë duhet të mbështeten nga hulumtimet e politikave të kryera në mënyrë shkencore. Kjo është për shkak se hartuesit e politikave preferojnë të shohin literaturën akademike që diskuton problemin për së afërmi dhe zgjidhjet e provuara dhe të atestuara për të. Edhe pse kjo mund të ngulfat kreativitetin në identifikimin e zgjidhjeve, është e rëndësishme që të kihet parasysh se audienca ka të ngjarë të jetë akademike dhe se ajo do të gjykojë argumentet e vëna përpara në mënyrë shkencore. Në mënyrë që të përmirësojmë bazën shkencore të argumenteve të tilla, revistat e mëposhtme dhe burimet e tjera mund të jenë burime të dobishme për t'u konsultuar:

- ▷ *Revista e të Mësuarit Aktiv në Arsimin e Lartë;*
- ▷ *Revista e Arsimit të Lartë;*
- ▷ *Revista Ndërkombëtare e Zhvillimit Akademik;*
- ▷ *Revista Mësimdhënia në Arsimin e Lartë;*
- ▷ *Bursat e rishqyrtuara. Prioritetet e Profesoratit (Boyer, 1990), dhe*
- ▷ *Të Mësuarit me Studentin në Qendër. Pasqyrë e Teorisë dhe Praktikës (EI, ESU, 2010).*

IV.4 IDENTIFIKIMI I ROLEVE PËR AKTORËT E NDRYSHËM

Pas marrjes së vendimit se ndryshimi me të vërtetë është i nevojshëm, është e domosdoshme të identifikohen personat e tjerë të cilët gjithashtu kërkojnë të njëjtin ndryshim. Ndryshimi nisët shpesh nga një "koalicion vullnetar", ose nga një grupim i vogël i atyre që bien dakord për problemin dhe nevojën për të ndryshuar.

Për ta bërë arsimin e lartë më shumë të fokusuar me studentin në qendër, është e dobishme për t'u lidhur me ligjërues, shoqatat profesionale dhe organizatat studentore që mund ta mbështesin projektin e ndryshimit dhe për të rritur rëndësinë e tij. Në përzgjedhjen e partnerëve të tillë në mënyrë efektive mund të aplikohen një sërë elementesh. Këto përfshijnë:

- ▷ *Llojin e mbështetjes që ata mund ta ofrojnë (morale, financiare, ekspertiza, koha, ndikimi);*
- ▷ *Lloji i marrëdhënieve që keni me ta (besimi, personale, hierarkike);*
- ▷ *Lloji i rezistencës që ka të ngjarë të zëvendësohet me përfshirjen e tyre (pasi përfshirja zakonisht çon në pjesëmarrje në vend të kundërshtimit) dhe*

- ◉ *Legjitimiteti që ata do t'i sjellin reformave (sipas premisë se një partneritet i ndërtuar në mënyrë të shëndoshë tingëllon më bindës).*

Më poshtë është dhënë një listë e aktorëve të mundshëm të ndryshëm që mund të përfshihen në një proces të tillë të ndryshimit dhe interesat të cilat ata mund t'i kenë:

- ◉ **Unionet e Studentëve:** Nuk është për t'u befuar se studentët janë shpesh përkrahësit më të fuqishëm të qasjes së SCL-së. Anketa e përbashkët e ESU-EI (2010) e ndërmarrë gjatë fazave fillestare të projektit T4SCL tregon se qëndrimet e unioneve të studentëve janë shumë pozitive për idenë. Në përgjithësi, prioriteti i tyre është që ta promovojnë atë si një çështje politike, duke argumentuar për një mjedis shumë më përkrahës për mësimnxënien. Në shumë raste, unionet e studentëve janë gjithashtu të gatshëm të zhvillojnë projekte në institucione, për të identifikuar përfaqësuesit e studentëve me përvojë për punën e projektit ose për të kryer rishikimet e proceseve të mësimnxënies në nivel institucional apo fakulteti. Në disa situata, unionet e studentëve mund të jenë të përqendruar në çështjet jo-akademike. Prandaj, do të jetë e dobishme që të identifikohen qartë përfitimet më të gjera të qasjes së SCL-së.
- ◉ **Sindikatat e Mësimdhënësve të Arsimit të Lartë:** Në mënyrë të ngjashme me unionet e studentëve, edhe sindikatat e mësimdhënësve kanë të bëjnë me çështjet profesionale të tilla si mësimdhënia dhe hulumtimet, si dhe me çështjet tradicionale të sindikatave të tilla si kushtet e punës të stafit mësimdhënës në arsimin e lartë. Ato mund të ofrojnë mësimdhënës dhe hulumtues me përvojë, si dhe një kontroll shumë të rëndësishëm real të kushteve të nevojshme për zbatimin e ndryshimeve të parapara. Sindikatat e mësimdhënësve janë aleate të rëndësishme pasi që mësimdhënësit shpesh shihen të kenë një qëndrim negativ ndaj qasjes së SCL-së. Nëse zëri i tyre është i përfshirë në një fazë të hershme, entuziazmi për ndryshime mund të rritet po ashtu edhe në terren.
- ◉ **Konferenca e Rektoreve, ose Shoqatat e Institucioneve të Arsimit të Lartë:** Modernizimi i arsimit të lartë dhe i mësimdhënies është një prioritet i qartë për shumicën e shoqatave të institucioneve të arsimit të lartë. Edhe pse shpesh kanë të bëjë me çështje të tilla si hulumtimi dhe financimi, këto organizata mund të jenë shumë të rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të ndryshimeve. Ato ndikojnë aktivisht në prioritetet e sistemit të arsimit të lartë, ato ofrojnë burime dhe kanë rrjetet e mendimtarëve me ndikim në arsimin e lartë. Duke mobilizuar disa nga këto burime, projekti i ndryshimit mund të rritet me anë të burimeve dhe vizibilitetit më të mirë. Me rastin e angazhimit të këtyre shoqatave, është e rëndësishme që të jemi të vetëdijshëm se ato kërkojnë një plan dhe vizion të qartë lidhur me problemin para se të angazhohen në projektin e ndryshimit.

◉ **Udhëheqja e Institucioneve të Arsimit të Lartë:**

Ashtu si organizatat e tyre ombrellë, udhëheqësit e institucioneve mund të ofrojnë burime dhe ekspertizë dhe mund të ndikojnë në prioritetet. Zakonisht ekzistojnë struktura specifike brenda institucioneve për t'u marrë me çështje të arsimit, siç është një zëvendës-ректор për çështjet akademike, një njësi të sigurimit të cilësisë ose një njësi të zhvillimit profesional. Në institucionet më të decentralizuara, ato ekzistojnë në nivel fakulteti ose të departamenteve. Këto struktura nuk janë të mobilizuara lehtë, pasi ato merren me iniciativa të ndryshme në të njëjtën kohë dhe shpesh ndryshojnë më ngadalë. Ekzistimi i një plani të qartë dhe një baze shkencore për argumentim do të ndihmojë për përfshirjen e tyre në projektin e ndryshimit.

TIP!

Pasi të keni mbledhur një numër njerëzish rreth tryezës, ju mund të përdorni Diagramin e Përgjegjësisë për të shpërndarë detyrat në mënyrë efektive. Këtu ju mund të përpiqeni që të skiconi se kush është i përfshirë në projektin tuaj dhe cili është roli i tyre në çdo fazë apo aktivitet. Ju mund të caktoni katër role të ndryshme për një person në çdo situatë: Përgjegjësia (P); Miratimi ose Drejta e Vetos (M-V); Përkrahja ose konsultimi (PK); ose Informimi (I)

- ◉ **Organizatat Punëdhënëse:** Organizatat e biznesit luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në qeverisjen e arsimit të lartë. Edhe pse njohuritë e tyre në arsimin e lartë zakonisht nuk janë shumë të larta, ato zakonisht kanë njohuri mjaft të mira për problemet e punësimit për të diplomuarit. Prandaj, ato janë përgjithësisht në favor të një qasjeje me studentin në qendër që ka për qëllim pavarësinë personale dhe të mësuarit më efektiv. Ata mund të ofrojnë ekspertizë në çështjet e punësimit, si dhe burime për projekte në të cilat ata e shohin një përfundim të qartë dobiprurës.

Ak Shembull i Diagramit të Përgjegjësisë për Projektin që përfshinë

Aktori	Përgjegjësia	Miratimi ose vetoja	Përkrahja ose konsultimi	Informimi
Unioni i Studentëve	P	V	.	.
Sindikata e Mësimdhënësve	P	V	.	.
Konferenca e Rektorëve	.	M	K	.
Ministri	.	.	.	I

- **Media:** Shtypi ndoshta nuk është shumë i interesuar për të shkruar artikuj që kanë të bëjnë me shndërrimin e arsimit të lartë më shumë me studentin në qendër. Megjithatë, mediat e ndryshme mund të jenë të rëndësishme në lidhje me imazhin publik të sistemit të arsimit të lartë. Nëpërmjet botimit të fakteve dhe shembujve të përzgjedhur të problemeve të hasura nga studentët në sistem, argumentet mund të vendosen publikisht shumë shpejt që t'i kushtohen më shumë vëmendje dhe burime SCL-së.
- **Individët:** Ekspertët, studentët individual, kolegët apo miqtë mund të jenë të dobishëm për të siguruar persona shtesë si anëtarë të ekipit të ndryshimeve. Duke mbledhur përzierjen e duhur të pjesëmarrësve, secili me fushën e tij të ekspertizës, ekipi mund të ngrihet si i motivuar dhe i aftë në zbatimin e projekteve të ndryshimeve për të shkruar drejt zbatimit të qasjes së SCL-së. Për shembull, hulumtuesit arsimorë duke punuar në temën e SCL-së do të jenë në gjendje të japin këshilla të bazuara në prova teknike lidhur me zbatimin e SCL-së në një mënyrë të përshtatshme me profilin e institucionit të caktuar.

4.5 HAPI I TRETË: IDENTIFIKIMI I NXITËSVE PËR NDRYSHIME

Në mënyrë që të binden njerëzit për ndryshime, është e rëndësishme të dini se çfarë i motivon ata. Prandaj, është e domosdoshme që të identifikohen 'nxitësit', 'katalizatorët' apo 'stimujt' e ndryshimeve. Një mësim nga teoritë në lidhje me reformën është që individët duhet të shohin përfitimet në ndryshime. Ky përfitim mund të marrë forma të shumta (të tilla si shpërblime monetare, përmirësimin e cilësisë dhe motivimin e lartë) dhe duhet të identifikohet në mënyrë eksplicite. Përfitimet duhet të integrohen në politika konkrete dhe të qarta, në mënyrë që ato të bëhen nxitësit e ndryshimeve. Pas përfitimeve të SCL-së të identifikuar më lart në Kapitullin 2, nxitësit e mundshëm për ndryshime mund të jenë:

$$G = (P \times B \times V \times F) > K$$

Ku:

G është Gatishmëria për ndryshime;

P është Pakënaqësia me status quo-në;


B janë Benefitet e perceptuara të ndryshimeve për aktorin;

V është qartësia e Vizionit të përbashkët të asaj që është e mundshme;

F është Fizibiliteti i hapave për zbatimin e ideve të reja, dhe

K është për Kostot e ndryshimit.

fig. 3 Plotësimi Formulës së Gleicher-it mund të vë në dukje problemet e njerëzve që ju mendoni se duhet të **NDRYSHOJNË!**



- ◉ **Stimujt personal:** Për mësimdhënësit, mësimdhënia bëhet më e këndshme, interaktive dhe e dobishme në qoftë se ajo është me studentin në qendër. Për studentët, mësimxënia bëhet më interesante nëse është interaktive;
- ◉ **Stimujt arsimorë:** Mësimdhënia mund të jetë më efektive nëse ajo përfshin të mësuarit konstruktiv. Studentët do të jenë në gjendje të mësojnë më mirë në një mjedis të tillë, duke e bërë më kuptimplotë kohën që ata e kalojnë në arsimin e lartë;
- ◉ **Stimujt me bursa:** Puna kërkimore mund të integrohet në mësimdhënie, duke prodhuar lidhje të ngushtë me aktivitetet kërkimore të mësimdhënësit. Për studentët, gjithashtu do të përmirësohet lidhja me botën akademike dhe mundësitë për një karrierë akademike; dhe

- **Stimujt ekonomik:** Nëse niveli akademik e përmirëson mësimdhënien e tij, atëherë për ta do të jetë e mundshme të futen në nivele më të larta të shkallës së karrierës. Për studentët, cilësia e lartë e arsimit mund të ofrojë qasje për të gjetur punë të nivelit të lartë në tregun e punës.

Është e mundshme të vlerësohet nëse njerëzit janë të gatshëm për të ndryshuar apo jo. Një version i përshtatur i Formulës së Gleicher-it mund të jetë një mjet i dobishëm. Nevojitet të plotësohet formula në lidhje me aktorët kryesorë të përfshirë në një reformë të caktuar dhe të vlerësojmë nëse të gjithë faktorët i tejkalojnë kostot e ndryshimit të tillë. Nëse po, gatishmëria për të ndryshuar do të jetë pozitive. Në këtë formulë, faktorët P, B, V dhe K mund të ndikohen në mënyrë që të rrisin gatishmërinë për ndryshim.

Nxitësit e ndryshimeve shpesh tashmë janë pjesë e kulturës në institucionet e arsimit të lartë. Rezultatet e Indeksit të citimeve, shkalla e karrierës akademike ose format e vlerësimit të cilësisë janë vetëm disa shembuj të mjeteve të përdorura nga institucionet për të ndikuar në sjelljen e akademikëve. Është e rëndësishme që të mendohet për mënyrën se si këto mjete ndërliken ose punojnë kundrejt qëllimeve të projektit të ndryshimeve të planifikuara.

4.6 HAPI I KATËRT: STRATEGJITË PËR TË KAPËRCYER BARRIERAT E NDRYSHIMEVE

Identifikimi i barrierave ndaj ndryshimeve është po aq i rëndësishëm sa edhe krijimi i stimujve. Qëndrimet negative ndaj ndryshimeve ndoshta janë më problematike për reformën.

Barrierat e ndryshimeve janë zakonisht të ndryshme dhe mund të përfshijë:

- Pengesa administrative;
- Prioritetet e tjera për arsimin e lartë;
- Mungesën e mbështetjes financiare;
- Vendimmarrjen shumë të centralizuar (ose decentralizuar);
- Keqkuptimi i konceptit;
- Qëndrimet negative ndaj konceptit; dhe
- Të kuptuarit e ndryshëm të vizionit për të ardhmen.

Arsyet për qëndrime të tilla negative mund të jenë të shumta dhe përfshijnë përvojat e kaluara ku është kërkuar të bëhen ndryshime në disa drejtime të ndryshme në të njëjtën kohë, ose që kanë përjetuar përpjekjet e dështuara për ndryshime. Në çdo rast, është e nevojshme për të planifikuar një numër të qëndrimeve negative:

Është e dobishme që të identifikohen llojet e ndryshimeve të qëndrimeve negative ndaj projektit të ndryshimeve të planifikuara, të tilla si njerëzit të cilët japin reagime kthyes konstruktive, ata që janë skeptikë pragmatikisht dhe ata që me çdo kusht rezistojnë çdo plan të ndryshimeve. Llojet e ndryshme të rezistencës mund të adresohen me anë të strategjive të ndryshme. Këto mund të përfshijnë informimin më


të mirë të njerëzve, duke i përfshirë ata në vendimmarrje, duke u përpjekur për të ndërtuar kompetencat dhe besimin nëpërmjet trajnimit ose duke u përpjekur për t'i bindë ata dhe për të negociuar me ta për t'i adresuar nevojat e tyre më drejtpërdrejtë.

Kundërshtimi i ndryshimeve mund të jetë i dobishëm në qoftë se është mobilizuar drejt efektit pozitiv. Në qoftë se kundërshtimi trajtohet me seriozitet, ai do të jetë i dobishëm në identifikimin e aspekteve negative të planit të ndryshimeve, të cilat pastaj mund të përshtaten në përputhje me rrethanat. Në çdo rast, është mirë që të bëhet planifikimi për llojin e barrierave që mund të lindin, si dhe planifikimin i adresimit të atyre barrierave.

TIP!

Këshillë! Analiza e Fushës mund të jetë një mjet i dobishëm në këtë fazë. Ky është një mjet diskutimi me qëllim të identifikimit të aktorëve të ndryshëm, duke listuar të gjithë personat dhe organizatat e ndryshme që mund të kenë ndikim, si dhe hartëzimi i lidhjeve dhe niveleve të ndikimit të tyre mbi situatën.

fig. 4 Një shembull i analizës së fushës, duke përdorur disa nga aktorët e paraqitur më lart.



IV.7 HAPI I PESTË: ZBATIMI I NDRYSHIMEVE

Në këtë fazë, është e domosdoshme të gjeten dhe përdoren burimet për ta adresuar problemin. Kjo nuk bën pjesë në fushëveprimin e kësaj pakete të mjeteve për të prezantuar ide për mbledhjen e fondeve apo të japin sugjerime të përgjithshme mbi menaxhimin e projektit. Megjithatë, ekziston një literaturë me bollëk lidhur me çështjet e tilla, disa prej të cilave mund të gjenden në Kapitullin X më poshtë, ku janë listuar burimet për literaturë të mëtejshme. Gjithashtu, ekzistojnë shumë manuale të politikave të cilat tregojnë se planet mund të shoqërohen me një numër vështirësish. Me zhvillimin e projektit të ndryshimeve, mjetet e planifikimit të përmendura më lart dhe poshtë mund të përdoren për rikalibrimin e projektit të ndryshimeve, kur është e nevojshme.



IV.8 HAPI I GJASHTË: VLERËSIMI I NDIKIMIT TË NDRYSHIMEVE

Ndoshta, nuk është aq e lehtë për të vlerësuar ndikimin e një projekti të ndryshimeve. Treguesit e thjeshtë sasiorë siç është numri i njerëzve të ndikuar, numri i mësimdhënësve të trajnuar ose numri i rezultateve pozitive në formularët e vlerësimit të studentëve, nuk ofron edhe aq shumë të dhëna për ndryshimin aktual në përvojat e studentëve. Për më tepër, pasi që studentët ndoshta nuk kanë pasur me këtë situatë përvojë më parë dhe pas zbatimit të projektit të ndryshimeve, vetë studentët do ta kenë të vështirë për të vlerësuar ndikimin e ndryshimit pas zbatimit të Hapit të Pestë. Modelet standarde të vlerësimit për këtë arsye janë ndoshta joadekuate për të vlerësuar nëse ndryshimet që kanë çuar në zbatimin e qasjes së SCL-së ishin të suksesshme apo jo. Për fat të mirë, praktikat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë ofrojnë disa mjete për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve të ndërmarra.

Një model i integruar i planifikimit dhe vlerësimit është i ashtuquajturit modeli Planifiko-Puno- Verifiko-Vepro apo thjesht modeli PPVV (PDCA në anglisht). Ideja është që të gjitha këto faza janë të integruara në mënyrë eksplicite në projektin e ndryshimeve, duke bërë të mundur për të kontrolluar nëse ajo që ishte e planifikuar vërtetë është përbushur. Në fazën e 'verifikimit', është e rëndësishme që të përpiqemi t'i gjejmë dallimet midis asaj që është planifikuar dhe rezultateve të arritura. Në fazën e 'veprimt', është kyç identifikimi i arsyeve pse rezultatet e planifikuara nuk janë materializuar dhe përpjekja **për të zbatuar ndryshimet e duhura për planet.**

Është e rëndësishme të kuptohet se anëtarët e ekipit përgjegjës për drejtimin e ndryshimeve janë në gjendje që vetë të vlerësojnë ndikimin e punës. Kjo mund të bëhet me anë të vetë-vlerësimit që përpiqet për t'iu përgjigjur një numër pyetjesh. Këto përfshijnë si më poshtë:

- Cilat ishin qëllimet e projektit të ndryshimeve dhe metodat në përpjekje për t'i arritur ato qëllime?
- A janë aplikuar në vazhdimësi këto metoda?
- A ishin adekuate burimet për projektin e ndryshimeve dhe a janë përdorur ato në mënyrë të përgjegjshme?
- A e kanë kryer rolin e tyre partnerët e ndryshëm në projektin e ndryshimeve në nivel adekuat?
- A janë tejkaluar me sukses barrierat e ndryshme?
- A ka lindur ndonjë efekt anësor negativ në projektin e ndryshimeve?

Në vetë-vlerësimin e një projekti të ndryshimeve, anëtarët e ekipit mund të përpiqen të nënvizojnë përvojat e tyre dhe mendimet rreth projektit. Pas këtij hapi, një sërë metodash mund të përdoren për të parë nëse supozimet për efektivitetin e projektit ishin të sakta, të tilla si duke i pyetur kolegët apo studentët të cilët kanë qenë të ndikuar nga projekti për të komentuar vetë-vlerësimin e ekipit. Në mënyrë të ngjashme, unionet e studentëve, sindikatat e mësimdhënësve dhe aktorët e tjerë të përmendur më lart mund të konsultohen lidhur me ndikimin e projektit të ndryshimeve. Këto organizata zakonisht kanë një pasqyrë më historike të sistemit dhe mund të gjykojnë më gjerësisht ndikimet e tij. Është më e rëndësishme që të konsultoheni me ata të cilët janë vetë të përfshirë në procesin e të mësuarit pasi që ata do të jenë në pozitë më të mirë për të vlerësuar qasjen 'studenti në qendër' të sistemit.

5. ZBATIMI NGA MËSIMDHËNËSIT

5.1 HYRJE

Të mësuarit është paraqitur shpesh në një ballafaqim ndërmjet të mësuarit me studentin në qendër ose të mësuarit me mësimdhënësin në qendër. Në realitetin praktik situata është më pak bardhë e zi. Një prezantim më i dobishëm i SCL-së është që të shohim atë si një kombinim i të dyjave të cilat paraqiten si fund i vazhdimësisë, duke përdorur tre konceptet që rregullisht shfrytëzohen për të përshkruar SCL-në, si më poshtë:

Vazhdimësia e të mësuarit

Të mësuarit me mësimdhënësin në qendër	↔	Të mësuarit me studentin në qendër
Zgjedhje e ulët e studentëve	↔	Zgjedhje e lartë e studentëve
Pasiviteti i studentëve	↔	Aktiviteti i studentëve
Mësimdhënësit si mbajtës të pushtetit	↔	Fuqizimi i studentëve

Fol me mua ... dhe unë do të harroj
Më tregoi ... dhe unë do ta mbaj mend
Më përfshijë mua ... dhe unë do ta kuptojë
Më liro rrugën ... dhe unë do të veproj.
Konfuqie

Në shqyrtimin se si mund të duket kjo në praktikë, ia vlen të mendohet se sa larg mësimdhënësit e vazhdimësisë, në qasjen e tyre individuale, janë në gjendje për të lëvizur brenda barrierave kontekstuale të situatës së tyre. Kjo përfshin shqyrtimin e disiplinës së lëndës së tyre, madhësinë e klasës, infrastrukturën institucionale dhe traditat institucionale, ndër të tjera. Më poshtë janë dhënë disa elemente që mund të merren parasysh nga mësimdhënësit në arsimin e lartë brenda mjedisit të caktuar të klasës së tyre në mënyrë që t'i ndihmojmë ata për të vazhduar drejt zbatimit të qasjes së SCL-së, për të mirën e përvojës së mësimnxënies nga ana e studentëve të tyre.

5.2 MOTIVIMI I STUDENTËVE DHE NJOHJA E STUDENTËVE NGA MËSIMDHËNËSIT

Çfarë përgatitje kanë studentët?

Çfarë dinë tashmë ata?

Si kanë mësuar në të kaluarën?

Çfarë i solli ata në klasën tuaj?

Cilat janë interesat e tyre?

Cilat janë aspiratat e tyre

Në kuadër të roleve të ndryshme që SCL-ja parashikon për mësimdhënësit dhe studentët, faktor kyç në zbatimin e qasjes së re ndaj të mësuarit është motivimi i studentëve. Përfshirja më e madhe me studentët nga ana e mësimdhënësit është thelbi i kësaj. Aty ku studentët janë të motivuar për të kuptuar dhe për t'u angazhuar me materialin e prezantuar për ta, ata kanë më shumë gjasa të miratojnë strategjitë që do të çojnë në nivele më të thella të të mësuarit.

Më poshtë janë dhënë shembuj të praktikave të mira dhe ideve për mësimdhënësit për të rritur motivimin e studentëve:

- Përfshirja e studentëve në bashkë-krijimin e lëndëve obligative;
- Ekspozimi i studentëve ndaj pikave ekstreme të lëndës;
- Studentët bëhen më të vetëdijshëm për rrugët e ndryshme të karrierës që mund të jenë në dispozicion për ta pas përfundimit të studimeve të tyre;
- Studentët bëhen më të vetëdijshëm për rëndësinë e asaj që ata po bëjnë dhe konteksti i saj në një situatë të aplikuar që tregon vlerën e saj për të tjerët;
- Aplikimi i hulumtimeve të tyre në përvojën e të mësuarit të studentëve, parashtrimi i pyetjeve për metodat e përdorura dhe kërkimi i alternativave; dhe
- Ftesa për përfaqësuesit nga shoqëria me ekspertizë specifike dhe përvoja në lidhje me fushën e studimit ose ftesa e ish-studentëve (Alumni) për të shërbyer si modele të rolit, duke lidhur përvojat praktike dhe të mësuarit në profesionin e tyre me përvojat e fituara gjatë studimit të tyre.

Duke i bërë përvojat praktike më të qarta, studentët dhe profesionistët do të jetë në gjendje të lidhin teorinë dhe njohuritë dhe për të shkëmbyer njohuritë dhe aftësitë.

Përveç kësaj, ekziston një lidhje e demonstruar ndërmjet përvojave të mëparshme të studentëve dhe performancës së tyre si student. Duke marrë këtë informacion, mësimdhënësit do të jenë në pozitë më të mirë për të ndihmuar studentët duke rritur relevancën dhe në këtë mënyrë ndihmojnë në pasurimin e të kuptuarit të studentëve. Eksperiencat e mëparshme ndikojnë në pikëpamjet e studentëve lidhur me të mësuarit, motivimin e tyre për të mësuarit dhe mënyrën me të cilën ata i qasen të mësuarit.

Mësimdhënësit mund të lidhen më së miri me studentët, dhe anasjelltas, nëse ata e dinë sadopak se kush janë ata, përvojat e tyre të mëparshme dhe të kuptuarit e tyre të lëndës.

Ekzistojnë mënyra të ndryshme nëpërmjet të cilave mësimdhënësi mund të marr këto informata në lidhje me studentët e tyre. Në vijim janë dhënë disa shembuj:

- *Në grupe të vogla:* Mësimdhënësit mund të kërkojnë nga studentët që të intervistojnë njëri-tjetrin, duke i pyetur se pse ata zgjodhën këtë klasë, çfarë shpresojnë se do të marrin nga ajo dhe çfarë ata tashmë dinë për lëndën. Çdo student pastaj mund ta prezantoj të intervistuarin e tyre para pjesës tjetër të klasës.
- *Në grupe të mëdha:* Mësimdhënësi mund të bëjë përpjekje për të përdorur grupe të vogla që shkurtimisht të përmbledh njohuritë e çdo grupi lidhur me lëndën, duke e shkëmbyer këtë me tërë klasën.

5.3 ZGJEDHJA E METODAVE TË MËSIMDHËNIES DHE MËSIMNXËNIES

Në SCL ekziston një theks mbi aftësitë dhe kompetencat të cilat demonstrojnë përgjegjësinë për të mësuarit, pavarësinë dhe bashkëpunimin, zgjidhjen e problemeve, të kuptuarit dhe të menduarit për vetveten. Ekzistojnë një numër strategjish të përdorura si udhëzim, në mënyrë që të inkurajojnë këtë lloj të të mësuarit. Këto përfshijnë:

- *Nxitjen e studentëve për t'u bërë më aktiv në marrjen e njohurive dhe aftësive:* Kjo mund të marrë formën e aktiviteteve në klasë, punës në terren dhe përdorimin e pakove për të mësuarit e bazuar në kompjuter, ndër të tjera;
- *Studentët bëhen më të vetëdijshëm për atë që po bëjnë dhe pse ata po e bëjnë atë:* Kjo mund të bëhet duke përdorur përmbledhje të mësimnxënies, prezantimet analitike dhe të ngjashme;
- *Fokusimi në ndërveprim:* Siç është përdorimi i tutorëve, grupeve të interesit dhe diskutimi në grupe më të mëdha; dhe
- *Fokusimi në aftësitë e transferueshme:* Duke shkuar përtej kërkesave imediate të kursit për përfitimet e tjera për studentët më vonë në karrierën e tyre dhe në jetë.

TIP!

Këshillë! Merrni parasysh zvogëlimin e orëve të kontaktit, në mënyrë që të keni më shumë formate të SCL-së, aty ku është e mundur.

Brenda në klasë, zbatimi praktik i qasjes së SCL-së mund të përfshijë një numër komponentësh. Në vijim janë dhënë disa shembuj të këtyre komponentëve:

- ◉ Të mësuarit në bazë të problemit (PBL);
- ◉ Puna e projekteve në grupe;
- ◉ Të mësuarit aktiv me studentin në qendër;
- ◉ Të mësuarit bazuar në burime;
- ◉ Përdorimi i metodës së rastit;
- ◉ Luajtja e roleve;
- ◉ Punëtoritë në klasë;
- ◉ Prezantimet në grupe;
- ◉ Përdorimi i një mjedisi të ueb- konferencës, veçanërisht në arsimin në distancë; dhe
- ◉ Përdorimi i përbledhjeve të mësimit për studentët që të regjistrojnë përvojën e tyre arsimore.

Puna në grupe të vogla, shpesh përdoret në PBL, ajo iu mundëson studentëve të mësojnë se si të punojnë në ekip, në procesin të cilin ata e identifikojnë dhe i plotësojnë boshllëqet në njohuritë e tyre. Kjo është një metodë efektive e të mësuarit pasi që ajo aktivizon njohuritë e mëparshme, përforcon të mësuarit veçanërisht kur aplikohet qasja e bazuar në probleme në një kontekst të rëndësishëm (p.sh. me studentët e mjekësisë në një spital).

Për çfarëdo metode e mësimdhënies e përdorur, më e rëndësishmja është që të sigurojmë një rol AKTIV për studentin.

Ajo çfarë mësimdhënësit duhet të mbajnë në mend kur vendosin për aplikimin e metodës së mësimdhënies së SCL-së para një metode tjetër është audiencia e tyre - grupet e studentëve me të cilat ata duhet të merren. Jo të gjithë studentët janë të motivuar për të mësuar në të njëjtën mënyrë, kështu që stimujt e ndryshëm ose një kombinim i tyre mund të nevojitet në raste të ndryshme.

Brenda Formatit të Leksionit	Jashtë Formatit të Leksionit
<ul style="list-style-type: none"> ⦿ Grupeve të interesit (diskutim i shkurtër nga dy veta) ⦿ Snowballing (shndërrimi i grupeve të vogla në grupe më të mëdha) ⦿ Mbikalesa (përzjerja e studentëve në grupe) ⦿ Përdorimi i grupeve tutoriale ⦿ Rrethet (duke shkuar në rreth që të flet çdo student) ⦿ Kuizat ⦿ Shkrimi i refleksioneve mbi të mësuarit (kohëzgjatja 3-4 minuta) ⦿ Prezantimet e studentëve ⦿ Prezantimi i afisheve ⦿ Luajtja e roleve ⦿ Studentët prodhojnë hartat ideore 	<ul style="list-style-type: none"> ⦿ Projektet e pavarura ⦿ Diskutimi në grupe ⦿ Mentorimi nga kolegët i studentëve të tjerë ⦿ Puna ekipore ⦿ Debatet ⦿ Vizitat në terren ⦿ Çështjet praktike ⦿ Ditarët reflektues, përmbledhjet e mësimeve ⦿ Të mësuarit me ndihmën e kompjuterit ⦿ Shkrimi i artikujve në media ⦿ Zhvillimi i portofolave

V.5 ZGJEDHJA E METODAVE TË VLERËSIMIT TË STUDENTËVE

Vlerësimi i studentëve është një nga elementet më të rëndësishme të arsimit të lartë. Rezultatet e vlerësimit kanë një efekt të thellë në karrierën e studentëve në të ardhmen. Prandaj është e rëndësishme që vlerësimi të kryhet në mënyrë profesionale gjatë gjithë kohës dhe që merr parasysh njohuritë e gjerë të cilat ekzistojnë në lidhje me proceset e ekzaminimit dhe testimit.

Kontratat e të mësuarit janë qëllimet e caktuara nga studentët në varësi të mangësisë së tyre të të mësuarit, të cilat janë nga ana e negociuar me mësuesin në drejtim të asaj për të studiuar dhe si për t'u vlerësuar

Brenda qasjes SCL lindin një numër vështirësish në lidhje me konceptin e vlerësimit të studentëve. Kjo vlenë shkaku se vlerësimi zakonisht krahason studentët me njëri-tjetrin, duke theksuar konkurrencën në vend të përmirësimit personal. Kjo ndodh veçanërisht në rastin kur mënyrat përmbledhëse të vlerësimit të studentëve në të cilat dhënia e notave është zakonisht e mbi-theksuar, përderisa dhënia e këshillave dhe funksioni i të mësuarit janë të nënçmuara.

Praktikat e vlerësimit të studentëve duhet të pasqyrojnë, të inkurajojnë dhe të shpërblejnë qasjen e SCL-së. Mësimdhënësit duhet të jenë në dijeni për çfarëdo mospërputhje mes asaj që ata e kërkojnë nga studentët dhe asaj që vërtet ata duan ta dinë studentët.

Kjo nuk do të thotë se vlerësimi i studentëve nuk është në përputhje me qasjen e SCL-së. Përkundrazi, ai duhet të përshtatet për të pasqyruar filozofinë dhe qëllimet e SCL-së. Në SCL, në të njëjtën mënyrë ashtu sikur metodologjitë e përdorura të mësimdhënies duhet të jenë të dizajnuara për të dhënë reagime kthyesë për studentët në procesin e të mësuarit në funksion të rezultateve të dëshiruara të të mësuarit, format më të mira të vlerësimit duhet të harmonizohen me qëllimet e caktuara të mësimin. Kështu, duhet të përdoren format e vlerësimit që dëshmojnë arritjet e rezultateve të përcaktuara në procesin e të mësuarit nga ana e studentëve. Përndryshe studentët nuk do të marrin seriozisht qëllimet e tilla. Përveç kësaj, studentët duhet të informohen në mënyrë të qartë në lidhje me strategjinë e vlerësimit që përdoret për programin e tyre, çfarë provimesh ose metoda të tjera vlerësimi do t'iu nënshtrohen, çfarë do të pritet prej tyre dhe kriteret që do të zbatohen për vlerësimin e performancës së tyre.

Shembuj të praktikës së mirë në aspektin e Metodave të Vlerësimit në përputhje me qasjen e SCL-së përfshijnë:

- **Vlerësimi formativ:** Në krahasim me vlerësimin përmbledhës, kjo mënyrë thekson nevojën për t'iu ofruar reagime kthyesë studentëve lidhur me të mësuarit e tyre duke bërë kështu përvojën e të mësuarit për studentët më autentike dhe duke siguruar fokusin për studentët nëpërmjet nënvizimit të mangësive në të mësuarit e tyre dhe fushat të cilat ata mund t'i zhvillojnë. Kjo mund të marrë një sërë formash, duke përfshirë: ditarët, shkrimet dhe revistat, portofolat, vlerësimin nga kolegët apo vetë-vlerësimin, kontratat e të mësuarit dhe vlerësimet e negociuara, projektet, punën në grup, profilizimin dhe identifikimin e aftësive personale dhe kompetencat.
- **Vlerësimi sipas kriterit:** Kjo mënyrë vlerëson studentët kundrejt kriterëve të të mësuarit në lëndën e tyre, ndryshe nga vlerësimi i bazuar në normë i cili vlerëson studentët në krahasim me studentët e tjerë. Një nga përfitimet e këtij lloji vlerësimi është se mësimdhënësit dhe studentët e kanë më lehtë ta shohin se në cilat pika studentët janë më të suksesshëm dhe ku nuk janë të suksesshëm. Kjo mund të jetë e paçmuar në përmirësimin e kursit (lëndës) për studentët e ardhshëm.
- Vetë-vlerësimi dhe vlerësimi nga kolegët ia kalojnë përgjegjësinë përsëri studentit, duke theksuar një ndjenjë të rritur të autonomisë tek studenti.
- Kontratat e të mësuarit janë qëllimet e përcaktuara nga studenti varësisht nga boshllëqet e tyre në mësim, të cilat më pas negociohen me mësimdhënësin në aspektin se çfarë duhet të studiohet dhe si duhet vlerësuar.

Metodat e mundshme të vlerësimit dhe objektivat e tyre

Burimi: Universiteti i Adelajdes , 2000

<i>Vlerësimi</i>	<i>Shembull i Objektivave</i>	<i>Vlerësimi</i>	<i>Shembull i Objektivave</i>
<i>Eseja ose detyra e shtëpisë</i>	<ul style="list-style-type: none"> ● Përgatitni argumentet dhe analizoni ato ● Kërkoni informata relevante ● Organizoni prezantime efektive ● Integroni idetë ose teoritë ● Shprehni idetë në mënyrë adekuate 	<i>Puna në kurs (vlerësimi i vazhdueshëm)</i>	<ul style="list-style-type: none"> ● Mbani motivimin e duhur ● Merrni pjesë në punën në klasë ● Zhvilloni teknikat në përputhje me qëllimet e kursit ● Ruajeni interesimin ose energjinë ● Lidhni detyrat e ndryshme me njëra-tjetrën
<i>Provimi me libër hapur</i>	<ul style="list-style-type: none"> ● Ripërtëri informatat dhe idetë nga burimet ● Materiali referues në mënyrë adekuate ● Apliko informatat për situatat përkatëse ● Mbani mend idetë apo strukturat kryesore 	<i>Detyrat e simuluar</i>	<ul style="list-style-type: none"> ● Dëshmoni qëndrimet e duhura ● Ndërveproni me të tjerët në aplikimin e njohurive ose përvojave ● Analizoni ose sintetizoni idetë ● Demonstroni kreativitetin ose imagjinatën
<i>Detyrat e propozuara nga studentët</i>	<ul style="list-style-type: none"> ● Tregoni njohuritë e qëllimeve të kursit ● Demonstroni të kuptuarit e strukturës dhe materialeve të kursit ● Demonstroni të kuptuarit çështjeve kyçe 	<i>Projektet në grupe</i>	<ul style="list-style-type: none"> ● Bashkëpunimi Përfitimi nga situatat e 'jetës reale' ● Vlerësimi i aftësive personale ● Integrimi me pikëpamjet ose modelet e tjera
<i>Komunikimi me gojë</i>	<ul style="list-style-type: none"> ● Ballafaqohuni me pyetjet dhe argumentet ● Tregoni arsytimin pas deklaratave apo ideve ● Ndërveproni me të tjerët ● Përdorni gjuhën e përgjithshme / teknike në mënyrë të përshtatshme ● Shprehni idetë rrjedhshëm 	<i>Puna e projektit</i>	<ul style="list-style-type: none"> ● Kërkoni informata ● Arsyeya ● Planifikoni studimin sipas një intensiteti adekuat ● Organizoni informatat për qëllime të veçanta ● Prezantoni idetë ● Të jeni origjinal ● Mbështetni motivimin e duhur

- ◉ Zgjedhja është një nga aspektet kyçe në qasjen e SCL-së. Në vlerësim, zgjedhja ka të bëjë me kriteret dhe standardet që do të përdoren, gjykimet e bëra nga kush janë bërë ato gjykime. Nuk është e lehtë për mësimmshënësit që në fakt t’iu ofrojnë studentëve autonomi dhe ndikim në vendim-marrje në një fushë të tillë siç është vlerësimi, sidomos duke pasur parasysh mënyrën sipas së cilës është kryer vlerësimi tradicionalisht. Në vijim janë dhënë disa ide se si kjo mund të bëhet, në lidhje me dy faza të rëndësishme - kur është dhënë detyra dhe pasi që është kryer detyra.

Fushat për përfshirjen e studentëve në vlerësim

<i>Fushat për përfshirjen e studentëve kur caktohet detyra</i>	<i>Fushat për përfshirjen e studentëve pas kryerjes së detyrës</i>
<ul style="list-style-type: none"> ◉ Zgjedhja e detyrës së vlerësimit ◉ Caktimi i detyrës së vlerësimit ◉ Diskutimi i kriterëve të vlerësimit të ◉ Caktimi i kriterëve të vlerësimit të 	<ul style="list-style-type: none"> ◉ Komentet për vetë-vlerësimin ◉ Reagimet kthyesë për komentet e vlerësimit nga kolegët ◉ Sugjerimi i notave/pikëve të vetë-vlerësimit ◉ Negocimi i notave/pikëve të vetë-vlerësimit ◉ Caktimi i notave/pikëve të vetë-vlerësimit ◉ Caktimi i notave/pikëve të vlerësimit të kolegëve

Mësimmshënësit mund ta shqyrtojnë mundësinë që të zhvendosin praktikat e vlerësimit lehtësisht drejt vazhdimësisë së qasjes të mësuarit me mësimmshënësin/studentin në qendër me ndryshime të vogla, por të rëndësishme, për shembull duke ofruar zgjedhje të temave për ese dhe pyetjet e provimit si pikë fillimi e menaxhueshme. Është e rëndësishme të nënvizojmë se për aq kohë sa studentët janë të përgatitur siç duhet për vlerësim, ata do t’iu përshtaten formave të ndryshme të përdorimit.

Në adresimin e cilësisë së përvijës së të mësuarit në kurs (lëndë) ose nivel të komponentit të programit, pyetja bazë që kërkon përgjigje është: A sigurojnë programet arritjen e rezultateve të synuara të të mësuarit të lëndës ose komponentit të programit?

Vlerësimi i kursit mund të bëhet në kuadër të dy kategorive të gjera (cf. Universiteti i Adelajdes, 2000):

Vlerësimi i rezultateve: Kjo ka të bëjë me cilësitë që kursi fut tek studentët. Në këtë lloj vlerësimi, mësimdhënësit mund të gjejnë ndonjëherë prej këtyre elementeve si më poshtë:

- ◉ A kanë marrë studentët e mi qëllimet e njohurive që unë i kam caktuar për ta?
- ◉ A janë tani ata mendimtarë kritik më të mirë se sa kur ata filluan kursin?
- ◉ A janë ata tani në pozitë më të mirë në përcaktimin dhe zgjidhjen e problemeve sesa studentët e mi të mëparshëm që kanë mësuar në mënyrë të ngjashme?

Vlerësimi i procesit: Kjo merr parasysh se çfarë ndodh gjatë procesit të të mësuarit/mësimdhënies dhe shqyrton funksionimin e kursit. Ky vlerësim varet nga ajo që mësimdhënësi synon ta bëjë. Ajo mund të përfshijë pyetjet e mëposhtme:

- ◉ A kam arritur t'u jap studentëve të mi stimujt (përmes vlerësimit dhe strukturës) për të zhvilluar të mësuarit e tyre të pavarur?
- ◉ A i kanë përfshirë vërtetë studentët e mi aktivitetet që i kam ofruar?
- ◉ A kanë arrit studentët të përgjithësojnë njohuritë e lëndës së tyre të aspekteve të botës jo-akademike
- ◉ A kam qenë komunikues efektiv?

🗨️ Çfarë është

vlerësimi efektiv?

🔑 Sigurimi që kursi (lënda) ose komponenti i programit iu mundëson studentëve të arrijnë rezultatet e synuara të të mësuarit.

TIPI

Këshillë! Në vlerësimin e rezultateve, janë të nevojshme masat bazë. P.sh. për të identifikuar nëse të diplomuarit kanë aftësitë më të mirë në zgjidhjen e problemeve në jetën e tyre pas-universitare, mësimdhënësit do të duhet të dinë nivelet aktuale të të diplomuarve për zgjidhjen e problemeve.

TIPI

Këshillë! Mundohuni që të mos vlerësoni tepër shumë në një kohë. Është më mirë për të vlerësuar disa aspekte të zgjedhura me kujdes dhe të menaxhueshme të kursit.

Është e rëndësishme për mësimdhënësit që të zgjedhin strategjinë më të përshtatshme të vlerësimit për secilin nga kurset e tyre. Ka një numër të burimeve të informacionit që mund të jenë në dispozicion për vlerësim. Këto përfshijnë (cf. ibid):

- *Studenti*: Për informata mbi zbatimin dhe cilësinë e mësimdhënies;
- *Vëzhguesit*: Për përshkrimin e procesit të klasës;
- *Shoqatat Profesionale*: Për të dhënat krahasuese të lidhura me standardet e pranuar;
- *Punëdhënësit*: Për informatat lidhur me kënaqshmërinë me aftësitë e të diplomuarve;
- *Materialet e kursit*: Për informata lidhur me planet mësimore dhe filozofinë;
- *Të diplomuarit*: Për perceptimet lidhur me rëndësinë e kursit në botën e punës, dhe
- *Rezultatet e vlerësimit*: Për më shumë informata për të parë se a janë arritur rezultatet e të mësuarit.

Metodat e ndryshme janë në dispozicion për të mblledhur informatat nga këto burime, duke përfshirë pyetësorët, intervistat, ditarët/learning logs, diskutimet, komentet (të pa/kërkuara), vëzhgimin, reagimet kthyesë në uebfaqet dhe rezultatet e punës së studentit.

Në veçanti, në vlerësimin e cilësisë së përvojave të mësimnxënies, nga studentët mund të kërkohet për të dhënë mendimin e tyre për një varg çështjesh, duke përfshirë:

- Leksionet dhe mësimdhënësit;
- Tekstet e përdorura;
- Mjetet teknike në dispozicion;
- Ngarkesa e studentit;
- Aktivitetet e të mësuarit;
- Koha e përdorur nga studenti për aktivitete të ndryshme;

TIP

Derisa pyetësorët janë të dobishëm, ato nuk janë mënyra e vetme për të marr reagime kthyesë nga studentët;

Pyetjet e thjeshta për studentët apo diskutime të hapura në klasë lidhur me përmbajtjen e kursit dhe metodat mund të dëshmojnë të jetë më e dobishme sesa pyetësorët;

Mbledhja e reagimeve kthyesë nga studentët duhet të ketë një qëllim të qartë - duke përfshirë përgjigjen për reagimet e tilla kthyesë dhe ndjekjen e tyre.

- ▷ Përmbajtja e kursit dhe çfarëdo mbivendosje me kurset e tjera;
- ▷ Perceptimi lidhur me aftësitë e transferueshme të arritura;
- ▷ Hapësira për diskutim në dispozicion gjatë kursit ose komponentit të programit;
- ▷ Përshtatshmëria e metodave të vlerësimit të cilat janë përdorur; dhe
- ▷ Perceptimi lidhur me faktin nëse janë arritur rezultatet e synuara të të mësuarit.

5.7 PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE PËR TË RRRITUR SCL-në

Derisa metodat e mësimdhënies dhe të mësimnxënies zhvillohen me kalimin e kohës, po ashtu zhvillohen edhe mënyrat e transferimit të njohurisë dhe mjeteve të cilat përdoren nga studentët për të mësuar. Kjo është vërtetuar në rritjen e arsimit në internet (online) dhe në distancë dhe në përdorimin e përditshëm të kompjuterëve, internetit dhe hapësirave interaktive online të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, si dhe në sistemet e avancuara të menaxhimit të informatave të cilat përdoren nga një numër i madh i institucioneve.

TIPI

Është e rëndësishme për mësimdhënësit që të përçojnë tek studentët nevojën për një balancë adekuate në përdorimin e burimeve të internetit jashtë klasës - duke iu ndihmuar studentëve të identifikojnë hierarkinë midis burimeve të ndryshme dhe për t'i përdorur ato në mënyrë adekuate në procesin e tyre të të mësuarit.

Në zbatimin e SCL-së, qasjet e mundshme lidhur me përdorimin e teknologjisë informative përfshijnë:

- ▷ Përdorimi i postës elektronike (e-mail), e cila rrit SCL-në si një medium aktiv se sa pasiv, duke mundësuar kombinimin e arsimit në distancë dhe në kampus me një përzierje fleksibile dhe duke ndihmuar për të ndërtuar reagimin kthyes të përdoruesit, monitorimin e staftit dhe rishikimin e kursit në procesin e mbajtjes së kursit;
- ▷ Përdorimi i internetit (pa tela) brenda në klasë që mund të përmirësojë bashkëpunimin dhe komunikimin në mes të studentëve dhe mësimdhënësve dhe e bën klasën më aktive dhe interesante;
- ▷ Përdorimi i internetit jashtë klasës, duke bërë të mundur të mësuarit në ato vende ku normalisht nuk bëhet mësimi, duke i zgjeruar informatat në ato vende ku zakonisht ato nuk janë në dispozicion, duke zgjeruar ditën e mësimi dhe hapjen e vendit për të mësuarit.



Kjo iu ndihmon studentëve të gjejnë informata nga një shumëllojshmëri burimesh, duke i përshtatur ato me stilet e tyre personale të të mësuarit dhe mbështetjen e mendimit kritik.

Infrastruktura e nevojshme për studentët që të angazhohen në disa forma të ndërveprimit me mësime të ndërhënës, grupet e studimit dhe bibliotekarët, duke çuar në zotërimin e përmbajtjes së lëndës, përfshi të gjitha format e mediave, qoftë të digjitalizuara, të shtypura apo multimedia. Teknologjia Informative për këtë arsye mund të jetë e dobishme si brenda klasës për të ndihmuar mësime të ndërhënës në krijimin e një mjedisi interaktiv në klasë, si dhe jashtë klasës, në mënyrë që të përmirësohen proceset e të mësuarit nga studentët dhe të plotësojë atë që është mësuar në klasë. Kjo mund të fuqizojë studentët për qasje në informata dhe t'i analizojnë ato në mënyrë kritike në kohën dhe hapësirën e tyre. Gjithashtu kjo mund të jetë një komponent shumë i dobishëm në projektimin e programeve të zhvillimit profesional.

TIP

Është e rëndësishme që mësime të ndërhënës të përdorin metodat e TI-së në klasë në mënyrë të plotë interaktive dhe jo thjesht pasive. P.sh. përdorimi i prezantimeve në programin Power-Point mund të rrezikojë të qenurit një mjet pasiv në qoftë se nuk përdoret në mënyrë adekuate.

6. ZBATIMI NGA INSTITUCIONET

6.1 HYRJE

Koncepti i SCL-së shtrihet përtej klasës, duke e bërë të paevitueshme shqyrtimin se si mund të zbatohet SCL-ja në praktikë në aspektin e një qasjeje më të gjerë institucionale, me qëllim të krijimit të mjediseve të fuqishme për të mësuarit në kuptimin filozofik, peda-

Unë kurrë nuk i mësoj nxënësit e mi; unë vetëm bëj përpjekje të sigurojë kushtet në të cilat ata mund të mësojnë

Ajnshtajni

gogjik, praktik, organizativ dhe infrastrukturor. Në këtë drejtim, roli i institucioneve të arsimit të lartë është për të stimuluar qasjen e SCL-së duke siguruar ambient adekuat në të cilin SCL-ja mund të gjejë aplikim me kalimin e kohës. Në zbatimin e SCL-së duhet të merren parasysh parimet e përmendura në Kapitullin 1. Në veçanti si subjektiviteti i SCL-së po ashtu edhe diversiteti ndërmjet institucioneve të ndryshme janë pika kyçe për të kuptuar se nuk ka metodë universale për zbatimin e SCL-së, veçanërisht në nivel institucional. Më poshtë është shqyrtuar

një shumëllojshmëri e fushave në lidhje me atë se çfarë mund të bëhet, në vend se çfarë duhet të bëhet, në formën e një portretizimi të praktikës së mirë për zbatimin e SCL-së. Në veçanti, është e rëndësishme ta keni parasysh se përderisa ne mund të jemi plotësisht në paretëdijshëm lidhur me çfarëdo praktike të SCL-së në institucionet tona, kjo nuk do të thotë se SCL nuk është e pranishme në punën e përditshme të akademikëve.

6.2 HARTIMI I KURRIKULËS DHE PËRDORIMI I REZULTATEVE TË TË MËSUARIT

Një nga fokuset kryesore të çfarëdo institucioni të caktuar është hartimi i programit mësimor (kurrikulës), si hallkë kryesore rreth të cilave përqendrohet misioni i çdo institucioni. Hartimi i kurrikulës është çështje themelore për organizimin e të mësuarit dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë që të rritet niveli i të mësuarit. Është me rëndësi që ta mbani në mend, gjatë gjithë kohës, që SCL-ja përfshin idenë se studentët kanë mundësi të zgjedhin se çfarë duan të studiojnë dhe si do të studiojnë. Përdorimi i krediteve (në Evropë kryesisht me anë të Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve - ECTS - në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë) dhe përdorim i moduleve ofrojnë një strukturë institucionale e cila iu mundëson studentëve një element të zgjedhjes se çfarë dëshirojnë të studiojnë.

Një praktikë në rritje e sipër në hartimin e lëndës (kursit) është hartimi i rezultateve të të mësuarit duke u fokusuar në atë që studenti do të jetë në gjendje ta bëjë, në vend se në përbajtjen që mbulohet nga mësimdhënësi.

Kjo praktikë është një tregues i lëvizjes drejt SCL-së në programet mësimore dhe ndihmon për të zhvendosur theksin mbi studentin. Ky është një theks mbi procesin dhe kompetencat, në vend se në përmbajtjen e lëndës.

Puna e studentëve duhet të tregojë se sa janë të suksesshëm studentët në proceset e tilla si krijikat të cilat i lexojnë ata, bërja e modeleve, zgjidhja e problemeve, shkrimi akademik, zbatimimi i parimeve dhe të menduarit në lidhje me konceptet.

Një politikë institucionale për identifikimin, përdorimin dhe komunikimin e rezultateve të të mësuarit nga të gjithë mësimdhënësit dhe në të gjitha kurset është e dobishme për institucionin sepse ajo ndihmon për t'iu siguruar se fokusi është në nevojat e studentëve në të gjitha kurset në fazën e hershme të hartimit të kurrikulës, duke rritur kështu në mënyrë holistike misionin e mësimdhënies në institucion. Përveç kësaj, është e rëndësishme për rezultatet e të mësuarit që të vlerësohen në mënyrë specifike dhe se reagimet kthyesë do t'iu ofrohen studentëve në një mënyrë që iu dëshmon studentëve rëndësinë e procesit të mësimit të ndërmarrë nga ana e tyre. Do të jetë e dobishme për institucionet që të krijojnë një strukturë në të cilën janë të hartuara rezultatet e të mësuarit. Një mënyrë për ta bërë këtë është duke krijuar një kornizë në të cilin, njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që do të ndërmerren deri në fund të çdo kursi të caktuar bëhen të qarta. Në këtë drejtim:

- 'Njohuritë' i referohen përmbajtjes së lëndës, të tilla si formulat matematikore, reaksionet kimike, ngjarjet historike, teoritë, modelet e ekzistencës, etj.
- 'Aftësitë' iu referohen mundësive, të tilla si aftësitë e intervistës, aftësi për lidhshmëri ekip, etj; dhe
- 'Kompetencat' i referohen proceset të ideve të përfshira në vendosjen e aftësive të tilla si mendimi kritik, të dëgjuarit aktiv, një qëndrim proaktiv ndaj të mësuarit, respekti për mendimin e të tjerëve, etj.

Deklaratat lidhur me rezultatet e të mësuarit karakterizohen zakonisht nga përdorimi i foljeve aktive duke shprehur njohuri, të kuptuarit, zbatimin, analizën, sintezën, vlerësimin, dhe të ngjashme. Është e rëndësishme që të hartohen rezultatet e të mësuarit në atë mënyrë që përshkruan se çfarë do të jetë në gjendje të bëjë studenti dhe do të dijë si rezultat i përvojave të tyre, duke bërë të mundur vlerësimin e të mësuarit. Sipas Udhëzimit të ECTS-së (Komisioni Evropian, 2009) ekzistojnë dy qasje në lidhje me

Rezultatet e të mësuarit

- Mundësi për studentët që të kuptojnë se çfarë pritet prej tyre dhe çfarë kanë arritur;
- Shërbejnë për të përcaktuar materialin thelbësor (bazë) në një njësi ose modul;
- Duhet të përcaktojnë tërësinë e materialit që duhet ta dinë studentët ose të jenë në gjendje ta bëjnë atë pas plotësimi të njësisë; dhe
- Përcaktimi se çfarë mund të vlerësohet me çfarëdo mjeti.

inkorporimin e vlerësimit në rezultatet e të mësuarit, si vijon:

- Duke hartuar rezultatet e të mësuarit si deklarata bazë, duke treguar kërkesat minimale për të marrë një notë kaluese, ose
- Duke hartuar rezultatet e të mësuarit si pika referimi që përshkruajnë nivelin e pritur tipik të arritjeve të studentëve të suksesshëm.

Deklaratat e rezultateve të të mësuarit për këtë arsye duhet të shoqërohen gjithmonë me kriteret e qarta dhe të përshtatshme të vlerësimit për përfundimin e suksesshëm të një kursi apo komponenti tjetër të programit, të cilat bëjnë të mundur që të përcaktohet nëse studenti ka fituar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e dëshiruara. Përveç kësaj, ata duhet të tregojnë qartë se cila qasje, nga të dy më lart, është përdorur.

TIP!

Këshilla për hartimin e rezultateve të të mësuarit

Rezultatet e të mësuarit duhet të jenë të qarta, pozitive, deklarata 'se unë mund ta bëjë këtë' dhe duhet ta bëjë:

- Të përmbajnë një folje të vetme;
- Të përmbajnë folje të cilat janë aktive dhe të qarta;
- Të përmbajnë folje të cilat janë përdorur për të inkurajuar të kuptuarit më të thellë nga studentët. Këto përfshijnë: reflektimin, hipotezat, ndërlidhjen, argumentimin, teorinë, shpjegimin, analizën.

Këshillë! Numri i rezultateve të të mësuarit duhet të kufizohet!

Shembulli 1: Nivel i vitit të parë/10 Njësi të krediteve në Kiminë Biologjike

Me përfundimin e Kursit studenti do të jetë në gjendje të:

- Jep shembuj të biokatalizës;
- Jep shembuj të nomenklaturës kimike në strukturat e komplikua;
- Identifikojë reaksionet organike në sistemet biokimike;
- Interpretojë mekanizmat në polimerizimin natyror, dhe
- Shoqërojë reaktivitetin biologjike me strukturën.

Shembulli 2: Kursi i ngjashëm, niveli i vitit të dytë

Me përfundimin e Kursit studenti do të jetë në gjendje të:

- Aplikoj nomenklatura kimike të strukturave të komplikua;
- Klasifikoj reaksionet organike në sistemet biokimike;
- Të dallojë mekanizmat në polimerizimin natyror, dhe
- Të nxjerr një përfundim të reaktivitetit biologjik nga struktura.

Shënim: Ndryshimi në përdorimin e foljeve tregon se kreditet e kursit të vitit të e dytë korrespondojnë me rezultatet më të avancuara se sa kursi në nivel të vitit të parë.

Burimi: Prezantim nga George Francis Konferenca e lansimit të T4SCL, Rumani, Maj 2010

6.3 VLERËSIMI I CILËSISË SË BRENDSHME TË PROGRAMIT TË PRAKTIKAVE TË VLERËSIMIT

Në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programit të brendshëm, në nivel sistemi, institucioni duhet të sigurojë se ekziston një fokusim i fuqishëm në cilësinë e praktikave të vlerësimit,

Studentët duhet të vlerësohen duke përdorur kritere të publikuara, rreguloret dhe procedurat të cilat zbatohen në vazhdimësi.

me rëndësinë kushtuar rezultateve të arritura të të mësuarit nga ana e studentit, kur krahasohen me rezultatet e synuara të mësimit ashtu siç janë hartuar në kohën e dizajnit të kurrikulës. Ndërsa zgjedhja e metodave të vlerësimit të studentëve është një komponent kyç që duhet të merret parasysh nga mësimdhënësi në zbatimin e qasjes së SCL-së, siç shihet më sipër, ajo është gjithashtu një aspekt qendror i rezultateve të të mësuarit të dizajnuara për një kurs të caktuar ose komponentë të programit.

Në nivel institucional, në aspektin e nevojës për të ndërlidhur rezultatet e të mësuarit dhe vlerësimit, është e dobishme të merren parasysh pikat e mëposhtme:

- Vlerësimi duhet të ketë synim të tregojë arritjet e rezultateve specifike të të mësuarit;
- Vlerësimi duhet të bëhet brenda një kornize tërësore që nuk shkel arritjet e tjera, rezultate jo –eksplicite;
- Vlerësimi duhet të jetë i projektuar për të siguruar që lidhjet e duhura janë bërë në mes të vlerësimit të një kursi apo komponenti të programit dhe rezultateve të përgjithshme të të mësuarit të programit, dhe
- Theksi duhet të vendoset për përdorimin e kujdesshëm të metodave të vlerësimit, në veçanti në drejtim të vlefshmërisë dhe besueshmërisë së tyre.

Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG) (ENQA, 2005), të miratuara nga Ministri përgjegjës për Arsimin e Lartë nën patronazhin e Procesit të Bolonjës në vitin 2005, janë shumë të qarta në lidhje me nevojën për procedurat e publikuara të cilat duhet të zbatohen në mënyrë konsistente.

ESG-të (Standardi 1.3) janë të dobishme për të mbështetur përpjekjet e institucioneve për të siguruar cilësinë e proceseve të tyre të vlerësimit. Në këtë drejtim, ESG i referohet nevojës për procedura të vlerësimit të studentëve që:

- Duhet të jenë të hartuara për të matur arritjen e rezultateve të synuara të mësim-nxënies dhe objektivave të tjera të programit;

- Të jenë të përshtatshme për qëllimin e tyre, qofshin diagnostike, formative ose përmbledhëse;
- Të kenë kritere të qarta dhe të publikuara për notim;
- Të ndërmerren nga ata që e kuptojnë rolin e vlerësimit në përparimin e studentëve drejt arritjes së njohurive dhe shkathtësive të lidhura me kualifikimin e tyre të synuar;
- Aty ku është e mundur, të mos mbështeten në gjykimet e ekzaminerëve të vetëm;
- Të merren parasysh të gjitha pasojat e mundshme të rregulloreve të provimit;

Parimet për të siguruar cilësinë e vlerësimit të studentëve

Burimi: ENQA, 2009

<i>Krahasueshmëria dhe konsistenca</i>	<i>Aplikimi i strategjive të vlerësimit dhe procedurave të cilat: Fokusohen në rezultatet e të mësuarit; Aplikohen në mënyrë të barabartë dhe në përputhshmëri përgjatë tërë disiplinave dhe institucionit; dhe Lejojnë krahasueshmërinë.</i>
<i>Llogaridhënia</i>	<i>Të gjithë individët dhe komisionet e përfshira në vlerësim duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të veprojnë në përputhje me përgjegjësitë e tyre specifike dhe të identifikueshme.</i>
<i>Transparenca</i>	<i>Kjo përfshin komponentët e mëposhtëm: Përgatitjen e strategjisë së vlerësimit që përdoret për një program të qartë dhe lehtësisht të disponueshëm për tërë stafin dhe studentët e përfshirë; Informimi i studentëve lidhur me formën dhe masën e vlerësimit të cilit ata do t'i nënshtrohen dhe çfarë do të pritët prej tyre; dhe Kriteret e përdorura të vihen në dispozicion për të gjithë stafin dhe studentët e përfshirë dhe relevante për rezultatet e mësim-nxënies së programit.</i>
<i>Përfshirja</i>	<i>I gjithë stafi i përfshirë në realizimin e një programi ose pjesëve të tij duhet të përfshihet në hartimin dhe zbatimin e strategjisë së vlerësimit të përgjithshëm dhe studentët duhet të kenë mundësi që të ofrojnë pikëpamjet e tyre mbi sasinë dhe llojin e vlerësimeve që ata i ndërmarrin përsipër dhe nëse ato konsiderohen si masa të 'drejta' dhe 'efektive' të të mësuarit dhe aftësive të tyre.</i>

- T'iu nënshtrihen rregullave të qarta që mbulojnë mungesën e studentëve, sëmundjet dhe rrethana të tjera lehtësuese;
- Të kryhen në mënyrë të sigurt në pajtim me procedurat e deklaruara të institucionit; dhe
- T'iu nënshtrihen kontrolleve të verifikimit administrativ për të siguruar saktësinë e zbatimit të tyre.

Rekomandohet që institucionet, në zbatimin e praktikave të vlerësimit, të sigurohen që këto janë:

- Hartuar me kujdes dhe janë proporcionale;
- Rishikuar në baza të rregullta, duke përfshirë edhe reagimet kthyes nga studentët;
- Pjesë integrale dhe kontribuues për procesin e mësimdhënies;
- Të fokusuar në rezultatet e identifikuara të të mësuarit;
- Të bazuara në kritere objektive që janë në dispozicion për të gjithë stafin dhe studentët e përfshirë, dhe
- I nënshtrihen sigurimit të cilësisë në program dhe nivele institucionale.

Tabela e mëposhtme përmbledh katër parimet gjithëpërfshirëse të cilat janë të rekomanduara për shqyrtim nga ana e institucioneve në përpjekjet e tyre për të siguruar cilësinë e vlerësimit të studentëve.

Të kuptuarit e qartë të termave vlerësim, standarde, cilësi dhe rezultate të të mësuarit duhet të jetë i pranishëm brenda një institucioni të caktuar Veçanërisht në lidhje me llogaridhënien dhe krahasueshmërinë, në nivel institucional, është e rëndësishme që raportet në nivel të fakultetit të rishikohen kundrejt raporteve të ekzaminerëve të jashtëm të institucionit ku këto janë në dispozicion ose kundrejt treguesve të tjerë institucionale dhe kombëtarë.

Është e rëndësishme që institucionet të kryejnë rishikimet e praktikave të vlerësimit për të siguruar pranimin e hapësirave të mësimit. Kjo veçanërisht është e lidhur me përpjekjet për të zbatuar qasjen e SCL-së, duke qenë se zgjedhja e mënyrës së vlerësimit mund të reflektojë drejtpërdrejt nëse qasja e të mësuarit është më shumë me studentin në qendër apo me mësimdhënësin në qendër. Në të vërtetë, sigurimi i cilësisë në nivel programi, me fokus në vlerësim, ofron informata të vlefshme për institucionet lidhur me efektivitetin e përkrahjes së studentëve.

6.4 ZHVILLIMI I VAZHDESHËM PROFESIONAL I STAFIT AKADEMIK

Zhvillimi i vazhdueshëm i qasjes SCL brenda çdo institucioni të caktuar përcaktohet kryesisht nga zhvillimi profesional i stafit ligjërues të arsimit të lartë, siç është shqyrtuar në kapitullin në vijim të këtij materiali. Mësimdhënësit kanë nevojë për udhëzime për t'u aftësuar që në mënyrë aktive të përdorin konceptet e SCL-së në zhvillimin e kursit të tyre, që më tutje do të përmirësonte mësimdhënien e tyre. Modelet e suksesshme të zhvillimit profesional përdorin metodat e qasjes së SCL-së, në mënyrë që të trajnohen mësimdhënësit në arsimin e lartë për të përdorur qasjen e SCL-së. Filozofia dhe metodat e përdorura në SCL janë aspekt kyç i procesit të të mësuarit për stafin mësimor, të cilët, sipas qasjes duke bërë duke mësuar, inkurajohen që të zhvillojnë praktikatat e SCL-së të cilat do të përdoren në mësimin e tyre. Programet e tilla të zhvillimit profesional duhet të përdoren me mësimdhënësit e rinj dhe me mësimdhënësit të cilët kanë më shumë përvojë, duke përforcuar idenë se SCL-ja është një qasje e cila kërkon ndryshim, përpjekje, reflektim dhe përditësim të vazhdueshëm.

6.5 PËRDORIMI I SISTEMEVE INFORMATIVE PËR TË MBËSHTETUR SCL

Formati i mëimit jashtë klasës është i një rëndësie qendrore për avancimin e SCL-së, ku ky format varet kryesisht në përdorimin e sistemeve informative dhe teknologjive. Përdorimi i literaturës së teknologjisë informative siç janë e-portalet me anë të cilave qasja në informata është qendrore në këtë drejtim si një masë për të ndihmuar studentët për të zotëruar përmbajtjen dhe për të zgjeruar hulumtimin e tyre, bëhet më shumë vetë-drejtues, dhe të marrin më shumë kontroll mbi të mësuarit e tyre. Iu takon institucioneve për të siguruar infrastrukturën për hapësira të tilla për të mësuarit në internet.

Hapësirat e pasura me teknologji online të cilat, në praktikë, shërbejnë si një hapësirë fizike për bashkëpunimin e studentëve, zbulimin dhe inovacionin mbështesin procesin e të mësuarit që ndodh brenda në klasë. Përveç kësaj, ato ofrojnë një numër shërbimesh virtuale duke bërë që, asistencë, kurset dhe burimet të jenë në dispozicion në internet gjatë tërë kohës. Në mënyrë që të mësuarit të shtrihet përtej kufijve fizikë të klasës, dhe që të mësuarit e tillë të vazhdojnë të jetë me studentin në qendër, nëse studenti është i pranishëm për mësimdhënësin ose e kundërta, është e nevojshme të krijohet një mjedis jashtë klasës për të mësuarit aktiv, rritjen dhe pasurimin nëpërmjet asistencës për hulumtime e fokusuar në studentët, duke arritur tek të gjithë studentët dhe shërbimet inovative mësimore të cilat iu mundësojnë studentëve të përparojnë sipas ritmit të tyre.

6.6 ROLI QENDROR I BIBLIOTEKAVE NË SCL

Roli i mësipërm na shtyn që të shqyrtojmë rolin vendimtar të bibliotekave në SCL, si pika kryesore ku ruhen, qasen dhe shpërndahen informatat. Në këtë aspekt, nga bibliotekat pritet që vazhdimisht të përshtatin rolin e tyre në mënyrë që të ruajnë rolin qendror në kuadër të mjedisit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Nga bibliotekarët gjithashtu pritet të luajnë role të ndryshme në avancimin e qëllimeve të SCL-së.

Roli i bibliotekave dhe i bibliotekarëve, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë, është pjesë përbërëse e procesit të SCL-së në katër fusha kyçe, si më poshtë:

- **Sigurimi i burimeve të informatave:** Në mënyrë të tillë ku roli tradicional i bibliotekës në përzgjedhjen, organizimin dhe ruajtjen, si dhe tërheqjen e informatave bëhet më i rëndësishëm pasi që informatat e tilla duhet të vihen në dispozicion në hapësirat jashtë kampusit;
- **Nxitja e partneriteteve dhe bashkëpunimi:** Në mënyrë të tillë ku bibliotekarët bashkëpunojnë me shumë me personelin nga departamentet e tjera brenda institucionit të tyre, duke përfshirë mësimdhënësit, në planifikimin e kurrikulës dhe mësimet, si dhe personelin tjetër të punësuar për të ofruar shërbimet e informatikë brenda institucionit të tyre. Kjo bëhet me qëllim që bibliotekarët të mund të ndihmojnë stafin ligjërues në përdorimin e teknologjisë në mënyra inovative gjatë tërë programit, në përzgjedhjen e burimeve të përshtatshme të teknologjisë dhe në bashkëpunim me komunitetin mësimor për planifikimin, projektimin, zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të planit efektiv të teknologjisë me studentin në qendër. Kjo gjithashtu ka për qëllim që t’iu mundësojë bibliotekarëve të ndihmojnë studentët që të vlerësojnë burimet në dispozicion për ta dhe për të ndihmuar stafin e informatikës të kuptojë nevojat e studentëve në hartimin dhe zbatimin e sistemeve për përkrahjen e studentëve të bazuara në TIK.
- **Zhvillimi i Aftësive të Studentëve për Literaturë së bashku me stafin ligjërues:** Kjo është një mënyrë për t’u siguruar se studentët e dinë se kur ata kanë nevojë të gjejnë informata, për të identifikuar informacionin e duhur për të adresuar problemin e tyre dhe për të gjetur, vlerësuar, organizuar dhe përdorur informatat në mënyrë efektive në adresimin e problemit më të cilin ata ballafaqohen. Për këtë qëllim, vetë bibliotekarët duhet të zotërojnë aftësi për t’u marrë me nevojat e ndryshme të studentëve dhe përdorimin teknologjik, në mënyrë që të ruhet parimi i qasjes së barabartë në informata; dhe

Ky përdorim i veçantë i teknologjisë, në kuadër të qasjes më të gjerë të SCL-së, mund të ndihmojë për të përmirësuar normën e mbajtjes së studentëve në një institucion të caktuar, që dëshmon idenë se studentët e konsiderojnë qasjen e SCL-së të jetë me shumë vlerë për ta.

- **Zhvillimi i Programeve Gjithëpërfshirëse:** Në mënyrë që të sigurohemi se informatat mund të arrihen edhe jashtë mureve fizike të ndërtesës së bibliotekës, në mënyrë që të jemi në gjendje për të akomoduar nevojat e ndryshme të studentëve dhe mësimit.

Institucionet për këtë arsye duhet të sigurojnë që teknologjitë moderne manipulohen dhe përdoren në mënyrë inteligjente jo vetëm nga mësuesit, por edhe nga bibliotekarët dhe i gjithë stafi lidhur me hapësirat ku mësojnë studentët, në mënyrë të tillë që të sigurojnë vende të shumta dhe hapësira për mësim për studentët me shkallën më të lartë të mundshme të qasjes në informata dhe ndërveprimet me të tjerët.

6.7 PROMOVIMI I NJË POLITIKE KOMBËTARE DHE KULTURËS SË SCL-SË

Përdorja e këto që u thanë më lartë fokusohen shumë në krijimin e mjedisit ideal për SCL direkt në lidhje me të mësuarit duke bërë të mundur brenda dhe jashtë kampusit, promovimi i qasjes SCL në nivel institucional gjithashtu varet shumë nga konteksti në të cilin operon një institucion i caktuar. Kështu përtej mureve fizike apo virtuale të një institucioni, është e rëndësishme për liderët institucional që të fitojnë mbështetjen e organizatave brenda vendit apo rajonit të tyre, të cilat përfshijnë organizatat politike, arsimore, ekonomike apo sociale. Në këtë aspekt, institucionet duhet të kërkojnë nga ministrat e arsimit që të marrin rolin udhëheqës duke theksuar një filozofi të unifikuar të arsimit e cila ka studentin në qendër, me qëllim që të konsolidohet një politikë e SCL-së e përcaktuar në mënyrë adekuate.

Prandaj është e rëndësishme të kuptohet se, si një kusht i domosdoshëm, në çdo kontekst dhe në çdo format kontinental, historik apo gjeografik, politika kombëtare ose rajonale, cilado që është e zbatueshme, është kyçe. Duke pasur parasysh këtë, duhet pasur kujdes që çdo qasje me studentin në qendër duhet të jetë e artikuluar qartë dhe thjesht, si dhe duhet të ekzistojnë mekanizmat për t'i mundësuar çdo hisedari në procesin edukativ të informohet plotësisht lidhur me proceset që rrjedhin nga qasja e tillë arsimore. Kështu, institucionet duhet të zhvillojnë, në përputhje me politikën kombëtare ose rajonale, sipas rastit, një ndjenjë të përkatësisë në politikën e gjerë të aplikueshme për qasjen e SCL-së, nëse aplikimi i qasjes me studentin në qendër do të shoqërohet me ndonjë masë të suksesit, sidomos në kërkim për të motivuar studentët dhe për të aplikuar metoda inovative për të stimuluar të mësuarit.



7. MBAJTJA E NJË KULTURE TË SCL-së

7.1 HYRJE

Ashtu siç dëshmon nevoja për rishikimin e rregullt të sistemit të praktikave të vlerësimit brenda një institucioni të caktuar, përtej çdo kërkesë për ndryshim apo zbatimim për herë të parë i një qasjeje të gjerë institucionale të SCL-së, SCL-ja është një kulturë që duhet të mbahet në një institucion në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që të krijojë vërtetë qasjen e SCL-së e cila është reflektive, e pastër dhe e hapur për zhvillim dhe përmirësim. Zbatimi i SCL-së në një aktivitet të vazhdueshëm, zhvillimi dhe reflektimi organizativ duhet të ndodhë në vazhdimësi në çdo institucion me anëtarët e komunitetit të tij, në mënyrë që çdo sistem i SCL-së të mbetet i qëndrueshëm.

7.2 PASOJAT E NJË QASJEJE TË PAPËRGATITUR PËR TË MËSUARIT

Një shembull i zbatimit të të mësuarit i bazuar në problem (PBL) në Universitetin e Mاستrihtit gjatë një periudhe prej tre dekadash (cf. Moust et al, 2005) thekson nevojën për të rigjallëruar procesin e të mësuarit pas kalimit të një periudhe kohore, në mënyrë që të kenë efekt rrishtë arsimore të një baze më solide. Shembulli i Universitetit të Mاستrihtit tregon se si PBL, e referuar më sipër si një nga metodat e mësimdhënies e përdorur në SCL dhe e aplikuar në Universitetin e Mاستrihtit që nga themelimi i saj në vitin 1976, është gërryer për një periudhë tridhjetë-vjeçare për shkak të një sërë ndryshimesh të cilat ose kanë ndodhur rastësisht, duke u zvarritur në mënyrë të gabuar dhe më pas duke u stabilizuar, ose të bëra nga zyrtarët e fakultetit nëpërmjet vendimeve të vetëdijshme. Këto ndryshime kanë përfshirë:

- **Ndryshimet lidhur me përpunimin e informacionit nga studentët në grup të ushtrimeve.** Këto ndryshime kanë lëvizur ngadalë me kalimin e kohës dhe kanë ndikuar negativisht në procesin e të mësuarit, duke rezultuar në një proces të dobët për drejtimin e grupeve të ushtrimeve. Kjo u shfaq me: rënien në kohën e vetë-studimit; përgatitje minimale nga studentët për grupin tutorial; eliminimin e fazave të ideve dhe elaborimit të hartuara fillimisht për grupet autoriale; një përkeqësim i sintezës dhe fazës së integritimit e projektuar në fillim, duke e zvogëluar atë në një raport të shkurtër mbi çështjet minore; dhe rënie e interesimit të studentëve dhe dëshirës për të mësuar, e manifestuar në përpjekjen e studentëve për të studiuar burimet e njëjta, ndër të tjera;

- ◉ **Ndryshimet për shkak të raporteve joadekuate student-staf në një fakultet.** Këto ndryshime janë pasojë e drejtpërdrejtë e kufizimeve financiare në lidhje me fondet kombëtare dhe janë manifestuar nga një rritje e numrit të studentëve në grupe tutoriale dhe kontraktimin e studentëve të avancuar për të udhëhequr grupet të ushtrimeve një herë apo disa herë në vit; dhe
- ◉ **Ndryshimet e shkaktuara nga frika e ekzagjeruar e mësimdhënësve se lënda nuk ishte mbuluar sa duhet.** Këto ndryshime ndodhën për shkak se disa anëtarë të stafit nuk kanë besuar se studentët ishin në gjendje të mbulojnë një sasi të mjaftueshme të lëndës nëpërmjet të mësuarit të pavarur dhe vetë-drejtues, duke u përpjekur që të drejtojnë aktivitetet e studentëve të tyre në mënyra të ndryshme. Kjo është shfaqur në: vetë mësimdhënësit të cilët iu japin studentëve burime specifike në vend të një liste të gjatë të burimeve për të mësuarit; duke i përgatitur udhëzuesit e tutorëve për ata tutorë që janë më shumë të orientuar në lëndë sesa të orientuar kah procesi; duke injoruar gradualisht një pjesë të analizës dhe të sintezës së tutorialit, duke paraqitur më pak sfida për proceset e të menduarit nga ana e studentëve; dhe erozionin e rolit të ligjërit, i cili fillimisht ishte menduar të realizohej pasi që studentët të jenë futur plotësisht në një fushë të caktuar.

Përvoja e Universitetit të Mاستrihit tregon se mungesa e fondeve, të kuptuarit e dobët të parimeve themelore nga personeli dhe studentët, përpjekjet e gabuara për të bërë qasjen më efektive dhe fokusi në dëm të përbajtjes së procesit, të gjitha kontribuojnë në erozionin e një sërë parimeve të ndërthurura që e bëjnë metodën e PBL-së të funksionojë. Ndryshimet shpesh delikate, të marra së bashku, mund të çojnë në rënien e aplikimit të një metode të tillë inovative të mësimdhënies me kalimin e kohës, pasi që stafi dhe studentët mund të jenë të pakënaqur me një kornizë arsimore të dështuar dhe inkonsistente.

7.3 IDETË PËR PËRMIRËSIMIN E VAZHDESHËM TË QASJES SË SCL-së

Ndryshimet e përmendura më lart tregojnë se si qasja e PBL-së, e cila ka përfaqësuar shtyllën e procesit mësimor në Universitetin e Mastrihtit, është shkatërruar me kalimin e kohës. Ato gjithashtu dëshmojnë nevojën për një kulturë të SCL-së (apo ndonjë tjetër kulturë të caktuar për procesin e të mësuarit), që të ushqehet dhe zhvillohet për të mirën e studentëve, me anë të:

- ◊ *Organizimit* - *Monitorimit*
- ◊ *Qëndrueshmërisë* - *Rishikimit të rregullt dhe*
- ◊ *Transparencës* - *Ripërtëritjes*
- ◊ *Promovimit* ...në të gjitha nivelet dhe në të gjitha vendet brenda një IAL.

Ndjekja e rrugës së ripërtëritjes së vazhdueshme është masa ideale për të luftuar zbehjen e interesimit dhe mungesës së zbatimit të qasjes së të mësuarit të përdorur në një institucion të caktuar.

Duke u bazuar në përvojën e Moust dhe të tjerëve (2005) dhe të Kember-it (2008), të cilët kanë shqyrtuar zbatimin e SCL-së në një universitetit të tërë, më poshtë janë prezantuar disa masa me të cilat institucionet mund të luftojnë erozionin e aplikimit të metodës së SCL-së dhe të rigjallërojnë programet e tyre:

- ◊ **Adresimi i shqetësimeve të mësimdhënësve në zbatimin risive arsimore:** Nëpërmjet investimit të kohës dhe mjeteve financiare në programet e zhvillimit profesional të cilat ndihmojnë mësimdhënësit të kuptojnë dhe zbatojnë idetë, aftësitë dhe qëndrimet në lidhje me metodat e reja të mësimdhënies. Është e një rëndësie të madhe që mësimdhënësit të jenë të trajnuar për të diskutuar dhe identifikuar zgjidhjet e problemeve në mësimdhënie dhe mësimnxënie, përderisa aplikohet qasja e SCL-së edhe në procesin e të mësuarit tyre;
- ◊ **Stimulimi i praktikës së mirë në aktivitetet e mësimdhënies:** Me pranimin e përpjekjeve të mësimdhënësve të cilët e çojnë përpara qasjen e SCL-së, aplikohet shpërblyeri i mësimin shembullor dhe duke ofruar mundësinë për të shpërblyerit e tillë që të shkëmbejnë sistematikisht praktikatat e mira të të mësuarit;
- ◊ **Ndërtimi i komuniteteve të mësimnxënies:** Nëpërmjet ndarjes së studentëve të rinj në grupe të cilat rregullisht takohen me njëra-tjetrën në grupe të ushtrimeve, të udhëhequr nga një grup i caktuar i mësimdhënësve, duke i bërë linjat e reageimeve kthyesë më të shkurtra dhe më të dukshme, si dhe duke iu mundësuar mësimdhënësve dhe studentëve të diskutojnë mënyrën në të cilën informatat janë përpunuar dhe ku janë adresuar avantazhet dhe disavantazhet e aktiviteteve të ofruara, duke bërë këshu të mundur krijimin e aktiviteteve të veçanta të interesit për komunitetin e caktuar të mësimnxënies;

- ◉ **Informimi më i madh i studentëve rreth ideve themelore të SCL-së:** nëpërmjet ofrimit të trajnimit fillestar për studentët në aftësitë e SCL-së (p.sh. duke punuar në grupe, drejtimin e mbledhjeve, duke dhënë reagime, duke bërë prezantime) dhe duke i përbërur studentët rregullisht me ide teorike që përbëjnë bazamentin e SCL-së, me qëllim që të ndihmojnë studentët për të kuptuar 'pse-në' e kësaj qasjeje në arsim;
- ◉ **Ndihma e gjerë për studentët që të kenë të mësuarit e vetë-drejtuar:** Nëpërmjet ofrimit për mësimdhënësit dhe studentët një kornizë të qartë konceptuale për t'i udhëzuar ata që të sigurojnë që qëllimet e të mësuarit vetë-drejtues dhe të pavarur janë kuptuar dhe interpretuar në mënyrë më të qëndrueshme, duke ndihmuar kështu të arrihen qëllimet e synuara të SCL-së. Në këtë drejtim, mësimdhënësit mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e studentëve me të mësuarit e vetë-drejtuar, duke ndihmuar ata që gradualisht të zotërojnë aftësitë njohëse dhe rregullative të të mësuarit për t'u bërë student të pavarur dhe për të mësuar gjatë gjithë jetës.
- ◉ **Ofrimi i formave më të shumëllojshme në formate arsimore brenda kontekstit të një mjedisi të SCL-së për studentët:** Duke iu ofruar atyre një rrjet të metodave të mësimdhënies, kështu atyre i jepen mundësi të ndryshme për të rritur kompetencat dhe aftësitë e të mësuarit të tyre në mjedise ndryshme bashkëpunuese dhe duke i lejuar ata që të përfjetojnë aktivitetet e ndryshme të të mësuarit të vetë-drejtuar;
- ◉ **Zhvillimi i mjediseve të SCL-së të mbështetura në kompjuter:** Duke përdorur multimedia për të siguruar një mjedis më të pasur të të mësuarit, duke lehtësuar vlerësimin më autentik dhe duke individualizuar praktikën, reagimin dhe reflektimin;
- ◉ **Adoptimi i formave të reja të vlerësimit:** Me adoptimin e formave të reja të vlerësimit të cilat shkojnë përtej testeve të thjeshta në letër dhe me laps drejt formave më të stimuluar të tilla si portofolet, vlerësimet nga kolegët dhe vetë-vlerësimi, dhe vlerësimi i aftësive të performancës në një grup tutorial; dhe
- ◉ **Adoptimi dhe përmirësimi i proceseve të Rishikimit të Cilësisë së Programit:** Aty ku vlerësimi i studentëve është një komponent kyç dhe ekipet e programit prodhojnë një raport vetëvlerësimi që adreson menaxhimin e programit, sigurimin e cilësisë, rezultatet e dëshiruara të të mësuarit, përmbajtjen, aktivitetet e të mësuarit, vlerësimin e studentëve dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, me deklaratat përkatëse të cilat pritet të mbështeten me dëshmi.

Është me rëndësi të mbanhet në mend se pikat e mësipërme janë ide të propozuara duhet të zbatohen në masën në të cilën e kërkon konteksti i tyre, ku ky kontekst përfshin konsideratat për dallimet në trupën e studentëve dhe trupën e mësimdhënies, si dhe në kontekstin kombëtar dhe historinë institucionale.

7.4 ZHVILLIMI PROFESIONAL I STAFIT LIGJËRUES

Edhe pse mund të supozohet se roli i mësimitdhënësit po lehtësohet në qasjen e SCL-së, pasi që fokusi zhvendoset mbi studentin, kjo nuk mund të jetë larg së vërtetës. Roli i mësimitdhënësit është vendimtar në implementimin e qasjes së SCL-së dhe në pajisjen e

Roli i mësimitdhënësit nuk ka të bëjë vetëm me komunikimin e njohurive, por edhe për të vepruar si iniciator, ndërtues i kornizës dhe konsulent.

studentëve me një kuptim të qartë të kësaj qasjeje të mësimitdhënësies. Për më tepër SCL-ja largohet nga koncepti i mësimitdhënësit si ligjërues dhe parasheh një rol më intensiv për mësimitdhënësin.

Kjo veçanërisht vlenë për shkak të një roli të tillë qendror të mësimitdhënësit, pasi që nga të gjitha sugjerimet e parashtruara në seksionin e mëparshëm, zhvillimi profesional është komponenti kryesor i domosdoshëm për mbajtjen e një kulture të SCL-së që rrit përvojën e të mësuarit të studentëve dhe me të vërtetë iu ndihmon atyre të arritur rezultatet e synuara të mësuarit për një kurs të caktuar ose komponentë të programit.

Kur i referohemi përpjekjeve të avancuara pedagogjike të kërkuara nga një mësimitdhënës në institucionin ku është aplikuar SCL-ja, është e rëndësishme të shqyrtohet domosdoshmëria e zhvillimit pedagogjik të mësimitdhënësit si plotësim për të mësuarit vetë-drejtues të studentëve që është parashikuar në SCL. Është interesante të shqyrtohen mënyrat në të cilat janë ndërmarr përpjekjet e tilla të zhvillimit profesional në kuadër të institucioneve, në mënyrë që të nxisin dhe të ruajnë një kulturë të vërtetë të SCL-së.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve duhet të përfshihet si pjesë e rëndësishme e bursave të mësimitdhënësies dhe të aplikohen paralelisht me përdorur për studentët që të mundësojë mësimitdhënës gjatë gjithë jetës edhe në mesin e mësimitdhënësve.

Në vijim janë dhënë disa elemente të praktikës së mirë në programet e zhvillimit profesional për stafin ligjërues (shih Kember, 2008; Lavoie et al, 2007) të cilat mund të provohen dhe testohen nga institucionet, të ndërgjegjshme për kontekstin në të cilin ato janë duke u zbatuar:

- **Përdorimi i një qasjeje interaktive të SCL-së në Programet e Zhvillimit Profesional:** Pjesëmarrësit e kurseve të tilla bëhen studentë në këtë proces dhe mësojnë se si duhet hartuar kurse që promovojnë SCL-në aktive dhe literaturën informative lidhur me klasën në të cilën ligjërojnë. Në këtë mënyrë mësimitdhënësit mësojnë se si të punojnë duke aplikuar mësimitdhënësien efektive me studentin në qendër gjatë mësimitdhënësies efektive, për të siguruar literaturën informative në aspektin kontekstual në vend se të ofrojnë udhëzime të përgjithshme bibliografike dhe të përdorin stile të shumta përfshirëse të të mësuarit mbi pedagogjinë ekskluzive;

- ◉ Qasja e SCL-së në trajnimin e mësimitdhënësve përfshin një proces të vazhdueshëm reflektiv për mësimitdhënësit në të cilin ata janë të angazhuar që të mendojnë për mënyren e të menduarit e tyre më qëllim të përmirësimit të pedagogjisë së tyre dhe mënyrës së ligjërimit.
- ◉ **Fokusimi i njohurisë së mësimitdhënësve lidhur me përdorimin e mjeteve teknologjike në procesin e të mësuarit:** Aty ku pjesëmarrësit mësojnë në lidhje me përdorimin e teknologjisë në atë mënyrë që është relevante për disipinën e lëndës së tyre dhe për studentët e tyre, në vend se në të bëhet sipas rastit;
- ◉ **Përdorimi i kritikave konstruktive për të përmirësuar procesin e mësimitdhënies:** Aty ku mësimitdhënësve nuk iu jepet mundësia vetëm për të zhvilluar qasjet e tyre ndaj të mësuarit në kurset e tyre përkatëse, por gjithashtu kanë hapësirë për të ofruar edhe kritika konstruktive ndaj kolegëve të tyre dhe të shkëmbejnë eksperiencat e tyre në një dialog si komunitet i dijetarëve;
- ◉ **Fokusimi në zgjidhjen e problemeve:** Aty ku nga pjesëmarrësit kërkohet të identifikohen problemet që kanë hasur gjatë mësimitdhënies së tyre më pas diskutohen në mënyrë që të identifikohen strategjitë e mundshme për kapërcimin e tyre.
- ◉ Të mësuarit duke bërë praktikë në programet e zhvillimit profesional respekton lirinë akademike të mësimitdhënësve për të vlerësuar në mënyrë kritike se cila praktikë e mësimitdhënies do të ishte më e mirë. Kjo pasqyron lirinë dhe përgjegjësinë përkatëse të çdo studenti të angazhuar në një proces mësimitor i cili zhvillohet me studentin në qendër.
- ◉ **Aplikimi i ideve dhe metodave të mësimitdhënies në praktikë:** Kjo mund të aplikohet me anë të një projekti grupor i cili iu mundëson pjesëmarrësve të përpiqen dhe të përjetojnë format interaktive të mësimitdhënies në një mjedis mbështetës.

7.5 ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE KUSHTET E PUNËS

Në konferencën e fillimit të projektit T4SCL, njëri nga seminarët në mënyrë specifike ka adresuar çështjen e zhvillimit profesional dhe kushtet e punës së mësimdhënësve në arsimin e lartë. Gjatë këtij seminari u është vërejtur se, pavarësisht nga kufizimet që mund të jenë të lidhura me burimet financiare dhe njerëzore brenda institucioneve për të implementuar programet e zhvillimit profesional për stafin ligjërues, mund të ketë pengesa të mëtejshme për krijimin e programeve të tilla të zhvillimit profesional. Këto përfshijnë si më poshtë:

- ◉ **Rezistenca e mësimdhënësve për të ndjekur trajnime e tilla:** Kjo mund të jetë për shkak të një interesi më të lartë në hulumtime sesa në mësimdhënie, ngarkesës tepër të lartë ose mungesës së realizimit të nevojës për përmirësimin e aftësive të tyre pedagogjike, në mesin e arsyeve të tjera;
- ◉ **Mungesa e vetëdijesimit nga strukturat qeverisëse lidhur me nevojën për Trajnimin e Mësimdhënësve:** Ekziston një rrezik i lartë i kësaj çështjeje ku strukturat e qeverisjes nuk janë përfaqësuese. Në raste të tilla, sistemi mund të mos vlerësojë plotësisht se mësimdhënësit kanë nevojë për mbështetjen e nevojshme për të ligjërues ashtu siç kanë nevojë studentët për mbështetjen e nevojshme për të mësuar.

Përderisa mund të ketë rezistencë ndaj këtyre programeve të zhvillimit profesional nga disa mësimdhënës, është e një rëndësie të madhe të punohet me personat që janë të gatshëm për të zhvilluar aftësitë e tyre për të rritur qasjen e SCL-së. Kjo gjithashtu do të ndihmojë institucionin për të testuar metodat pedagogjike të përdorura në kurse të tilla dhe rregullimin e hollësishtëm të tyre me kalimin e kohës, në mënyrë për të përmirësuar vazhdimisht këtë shërbim për mësimdhënësit.

TIP!

Këshillë! Filloni me ata që janë të gatshëm dhe pastaj gradualisht rriteni mbulimin e programeve të zhvillimit profesional me kalimin e kohës.

Është e rëndësishme të theksohet se programet e tilla të zhvillimit profesional për stafin ligjërues kanë rëndësi kyçe në ruajtjen e qasjes së SCL-së në një institucion të caktuar dhe duhet të përdoren si bazë me mësimdhënësit e rinj dhe me mësimdhënësit që kanë përvojë. Aty ku mund të shfaqet një formë e rezistencës ndaj trajnimeve të vazhdueshme për mësimdhënësit nga mësimdhënësit të cilët kanë marrë pjesë tashmë në kurse të ngjashme, është e rëndësishme të identifikohen rolet për mësimdhënësit e tillë, sidomos kur është fjala për shkëmbimin e praktikave të mira, problemeve të përjetuara dhe zgjidhjeve të aplikuar.

Përveç kësaj, është e një rëndësie kyçe adresimi i çështjes së ngarkesës së punës së stafit ligjërues që shoqërohet me zhvillimin e tyre profesional.

Kjo vjen si ngase, gjetjet e një studimi të kohëve të fundit nga EI konfirmojnë (cf. EI, 2010), se gjatë dekadës së fundit, akademikët kanë përjetuar një rritje të volumit të punës dhe veçanërisht në detyrat e tyre burokratike, ndërsa siguria e tyre në punë është gërryer gradualisht. Në vendet e OECD-së (cf. Santiago et al, 2008) një nga arsyt kryesore për rritjen e detyrave burokratike ka qenë masivizimi i arsimit të lartë, që nuk ishte shoqëruar me një rritje të stafit ligjërues, duke reflektuar një raport më të lartë student-staf dhe vëllim më të madhe të punës për stafin ligjërues, i shoqëruar me kërkesat në rritje për më shumë produkte në procesin e hulumtimeve.

Në seminarin e lartpërmendur, mësime të ndërsjella dhe studentët u pajtuan se mësime të ndërsjella kanë nevojë për një trajnim disiplinor dhe pedagogjik në kuadër të programeve të zhvillimit të tyre profesional. Së bashku ata kanë identifikuar se çfarë do të ishin rezultatet e dëshiruara të programeve të zhvillimit profesional. Kjo përfshinë që mësime të ndërsjella do të jenë në gjendje:

- Që vazhdimisht të përmirësojnë njohuritë e tyre lidhur me disiplinën e lëndës së tyre dhe të jenë në gjendje që ta transmetojnë këtë tek studentët e tyre;
- Të përdorin metoda të reja mësimore të cilat janë të zbatueshme për formacione të ndryshme të klasës dhe grupe të ndryshme të studentëve;
- Të përdorin metoda të ndryshme vlerësimi, në mënyrë që të vlerësojnë drejt nëse studentët e tyre kanë arritur rezultatet e synuara të mësuarit në fund të kursit të tyre ose komponentit të programit;
- Komunikimi në mënyrë efektive me studentët, duke kuptuar anët e forta të tyre dhe problemet me të cilat mund të përballen, duke ndihmuar studentët të realizojnë potencialin e plotë;
- Motivimi i studentëve dhe stimulimi i tyre që të jenë kreativ në të mësuarit e tyre;
- Komunikimi me studentët në lidhje me qasjen e SCL-së të cilën ata e aplikojnë, rëndësinë e këtij lloji të të mësuarit dhe çfarë ajo synon të arrijë;

Është e rëndësishme pasi që programet e zhvillimit profesional janë në vetvete INOVATIVE në mënyrën në të cilën ato janë realizuar!

E rëndësishme! Është shumë e rëndësishme të adresohet çështja e kushteve të punës së stafit ligjërues paralelisht me përmirësimin e aftësive të tyre pedagogjike përmes programeve të zhvillimit profesional.


- Nxitja e analizës kritike tek studentët – duke i mësuar studentët se si të mendojnë - si dhe aftësitë e transferueshme - duke i mësuar studentët që të jenë në gjendje të veprojnë në çdo situatë ku mund të kërkoet kontributi i tyre, dhe
- Të kuptohet rëndësia dhe të mësohet se si të përdorën kritikak konstruktive, për zhvillimin e mësimdhënies dhe punës kërkimore.

Përveç kësaj, mësimdhënësit dhe studentët në seminar u pajtuan se programet e zhvillimit

Q Si mund t'ua mësojmë mësimdhënësve të gjitha këto?

A Duke përdorur metodat e mësimdhënies të cilat janë të përshkruara në kapitullin V për mësimdhënësit për t'u përdorur në SCL. Të mësojmë mësimdhënësit në të njëjtën mënyrë që ju do të mësonit studentët në qasjen e SCL-së.

profesional duhet të sjellin së bashku mësimdhënësit përgjatë të gjitha disiplineve me qëllim që ata të jenë në gjendje të diskutojnë metodat e aplikuara në fushat e lëndëve profesionale, pikat e forta dhe të metat e metodave të tilla dhe zbatueshmërinë e tyre në disiplina të tjera. Në veçanti, mësimdhënësit dhe studentët në seminar theksuan nevojën që mësimdhënësit të jenë në gjendje ta kuptojnë se ata kurrë nuk mund të përfundojnë të mësuarit në lidhje me mësimdhënien e tyre, pasi që SCL-ja nuk është një kuti e mbyllur me një metodë e cila është e aplikueshme vetëm në një kohë. Përkundrazi, mësimdhënësit duhet ta kuptojnë se kultura e diskutimit dhe kritikak konstruktive në lidhje me aftësitë e tyre pedagogjike dhe disiplinore do të shërbejnë për të përmirësuar mësimdhënien e tyre si dhe hulumtimin. Në këtë kontekst, studentët në veçanti kanë avokuar për një komunitet të mjeshtreve dhe dijetarëve në të cilin studentët dhe mësimdhënësit rregullisht bashkëveprojnë, si brenda dhe jashtë hapësirës së klasës, me qëllim që të nxitet diskutimi që çon në përmirësimin e përvojës së përgjithshme të ligjërimit të mësimdhënësve dhe përvojës së përgjithshme të të mësuarit nga ana e studentëve.



8. KEQKUPTIMET E ZAKONSHME

Më poshtë janë përcaktuar, shpjeguar dhe ndarë shumë ide të para-konceptuara lidhur me SCL-në. Këto janë konceptet e përgjithshme dhe keqkuptimet në lidhje me SCL-në. Duke pasur parasysh përfitimet e listuara në Kapitullin II më lartë, mund të jetë e dobishme që të shkohet përtej këtyre keqkuptimeve, në mënyrë që plotësisht të përqafojmë elementet e qasjes së SCL-së.

SCL-ja NUK DO TË THOTË ÇDO GJË NË PRAKTIKË

Përderisa është e qartë se SCL nuk i referohet një metode të veçantë në çfarëdo mjedisi të caktuar, kjo nuk do të thotë se SCL nuk përbën asgjë në praktikë. Më saktë kjo do të thotë se SCL është mjaft fleksibile për t'u adaptuar dhe zbatuar në të gjitha fushat e studimit dhe të mësimin. Duhet së pari të sigurojmë që studentët janë në qendër të të mësuarit e tyre dhe se mësimdhënësi është një lehtësues në këtë proces të mësimnxënies, duke bërë të mundur të mësuarit, në vend se ta imponojë atë. Pasi që të vendoset kjo kulturë, idetë për praktika të mira të studimeve ekzistojnë për aplikim në raste të veçanta. Ajo çfarë duhet të mbahet në mend është se çdo mësimdhënës dhe çdo student është unik dhe kështu SCL mund të adaptohet për të gjitha nevojat.

SCL KËRKON NJË NUMËR MË TË MADH TË BURIMEVE

Sfida më e madhe në zbatimin për herë të parë të qasjes së SCL-së ka të bëjë me ndryshimin e mentalitetit të studentëve dhe mësimdhënësve, me qëllim që të ndihmohen ata për të pranuar qasjen e tillë të të mësuarit. Kjo është diçka që nuk kërkon burime shtesë. Ndërsa institucionet domosdoshmërisht nuk mund të ndërtojnë klasa të reja ose të instalojnë pako multi-mediale pa burime financiare shtesë, shumë mund të bëhet për të arritur SCL-në pa fonde shtesë në drejtim të inkurajimit të studentëve që të mësojnë në mënyrë aktive sipas mënyrave të shtjelluara në kapitujt e mësipërm.

SCL NUK ËSHTË E PËRSHTATSHME PËR TË MËSUAR NJË NUMËR TË MADHE DHE TË LARMISHËM TË STUDENTËVE

Përderisa është e vërtetë se numri i studentëve në institucionet e arsimit të lartë është duke u bërë gjithnjë e më i madh dhe më i larmishëm, idetë e parashtruara më lart për zbatimin e SCL-së mund të jenë shumë efektive në punën me grupet e mëdha dhe të ndryshme të studentëve. Një shembull i mirë është ai i një mësimdhënësi i cili iu jep studentëve një copë të vogël letre duke u kërkuar atyre që të shkruajnë një aspekt të kursit të cilin ata me të vërtetë e pëlqejnë si dhe një aspekt tjetër për të cilin ata janë të pasigurt dhe duan të bëjnë pyetje rreth tij. Madje edhe vetëm një seancë e tillë është një hap konkret në drejtim të zbatimit të SCL-së.

SCL kërkon të menduarit imagjinativ, por ajo mund të bëhet!

SCL-ja MINON PROFESIONIN E MËSIMDHËNIES

Disa pohojnë se profesioni i mësimdhënies nuk do të vlerësohen më nëse SCL-ja bëhet normë sepse ajo largon fokusin nga mësimdhënësi dhe e vendos atë mbi studentët. Siç u shpjegua më lart, ndërsa roli i mësimdhënësit është disi ndryshe në SCL, rëndësia e tij nuk zvogëlohet. Përkundrazi ai është një rol i aftësimit të studentëve për të mësuar, duke i udhëzuar ata në kursin e tyre apo komponentin e programit, në vend se vetëm të ushqehen me informata. Është e mundshme që profesioni i mësimdhënies vërtetë do të bëhet më i çmuar me një theks më të lartë të vendosur në SCL, sepse SCL-ja i vendos studentët si pjesë e komunitetit akademik, ku mësimdhënia e udhëhequr nga hulumtimet mund të bëhet një realitet dhe ku reagimet kthyesë janë më konstruktive.

STUDENTËT KANË MË SHUMË PUNË PËR TË BËRË NË SCL

SCL-ja domosdoshmërisht paraqet një ngarkesë më të madhe të punës për studentët. Por ajo kërkon një ri-organizim të kohës së studimit nga ana e studentëve, duke u përqendruar më shumë në aktivitetet e vërteta të të mësuarit në vend se të mësohen përmendësh informatat. Kjo iu mundëson të diplomuarve që të jenë më efektiv dhe të adaptueshëm, duke i bërë ata më të përgatitur për të zgjidhur problemet që mund të shfaqen.

MËSIMDHËNËSIT DUHET TË BËJNË MË SHUMË PUNË PËRGATITORE NË SCL

Në metodat më tradicionale të mësimdhënies, mjaft shpesh ndodh që mësimdhënësit kanë shumë punë përgatitore për të bërë në mënyrë që të sigurohen se studentët e tyre do të jenë në gjendje të marrin shënime nga ligjërata e tyre në klasë dhe pastaj t'i përsërisin ato në provimet e tyre. Përdërisa mësimdhënësit do t'u duhet të ri-shqyrtojnë mënyrat e tyre të mësimdhënies, është e mundshme që puna përgatitore në periudhën afatgjatë nuk do të rritet dhe se puna e tyre do të jetë më e këndshme.

PROBLEMI I BAZUAR NË TË MËSUARIT ËSHTË I NJËJTË SI NË SCL

Të mësuarit duke u bazuar në problem (PBL) është një metodë e të mësuarit në të cilën studentët në mënyrë bashkëpunuese i zgjidhin problemet dhe pastaj reflektojnë mbi përvojat e tyre. PBL është një metodë e mësimdhënies në të cilën mund të aplikohet qasja e gjerë e SCL-së, por ka shumë alternativa për këtë metodë, siç është hulumtuar më sipër. Prandaj SCL-ja është ombrellë në të cilën bën pjesë PBL-ja. Ato nuk janë e njëjta gjë.

SCL-ja NUK ËSHTË E PËRSHTATSHME PËR TË GJITHA FUSHAT AKADEMIKE

SCL-ja është lehtësisht e adaptueshme për të gjitha temat dhe kurset, edhe pse mënyra praktike në të cilën ajo zbatohet mund të ndryshojë. Në të gjitha kurset dhe komponentët e programit, studentët mund të vihen në qendër. Përdorimi në rritje i sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, i zbatueshëm në të gjitha fushat akademike, mund të jetë një mjet që rrit aplikimin e kësaj qasjeje. Disa ndryshime do të shfaqen me rastin e ligjërimit gjatë gjithë temave të ndryshme të lëndës, me një dallim të dukshëm ndërmjet shkencave humane dhe shkencave tjera. Megjithatë, SCL ofron një filozofi themelore të të mësuarit e cila mund të përdoret në të dy fushat.

STUDENTËT E SCL-së MËSOJNË SHUMË PAK LËNDË PROFESIONALE

Në të kundërtën, studentët që kanë mësuar në këtë mënyrë ka të ngjarë të dinë më shumë. Ata mund të dinë më pak fakte të përsëritshme, por ka të ngjarë që të dinë më shumë për zgjidhjen e problemeve për veten e tyre, duke menduar për veten e tyre në një mënyrë analitike dhe duke u të angazhuar në hulumtime. Pas përfundimit të arsimit të lartë, është më e dobishme për të diplomuarit të jenë në gjendje që të aplikojnë aftësitë e transferueshme në vend se të kthejnë mbrapa sasinë e saktë të informatave që janë transferuar te ta.

JO TË GJITHË MËSIMDHËNËSIT MUND TË LIGJËROJNË SIPAS MËSYRËS ME STUDENTIN NË QENDËR

Të gjithë mësimitdhënësit janë në gjendje të aplikojnë qasjen e SCL-së! Nuk ka rëndësi nëse një mësimitdhënës ka qenë në profesion për disa muaj apo për shumë vite. Megjithatë, siç shpjegohet më lart, të gjithë mësimitdhënësit kërkojnë mbështetje për mësimitdhënien e tyre në formën e zhvillimit profesional, i cili është imperativ për suksesin e zbatimit të qasjes së SCL-së.

SCL-JA KËRKON QË TË BAZOHET NË TEKNOLOGJI

SCL-ja mund të inkorporojë aspektet e e-mësimit për studentët dhe mundësinë e të mësuarit në distancë, duke siguruar fleksibilitetin e shtuar për aty ku mund të bëhet dhe si mund të bëhet mësimitdhënësia. Siç shihet më sipër, përdorimi i teknologjisë është gjithashtu i dobishëm si brenda ashtu dhe jashtë formatit të klasës në rritjen e përvojës së të mësuarit të studentëve, duke u lejuar atyre që të japin reagime kthyes në mënyra të ndryshme dhe informatat burimore sipas nevojës. Megjithatë, përdorimi i internetit si dhe burimeve dhe hapësirave për të mësuarit online, të gjitha këto përfaqësojnë zhvillimet të cilat tashmë kanë zënë vendin e tyre në praktikën e institucioneve të arsimit të lartë. Kështu që SCL-ja nuk kërkon asgjë më shumë sesa çfarë është e nevojshme tashmë në shumë raste.



9. SCL-ja DHE PROCESI I BOLONJËS

9.1 HYRJE

Në tërë Evropën ekziston një pranim i përgjithshëm që SCL-ja është një qasje e të mësuarit që fokusohet në nevojat e studentit në vend se të fokusohet në ato të tjerëve të përfshirë në procesin arsimor. Gjithashtu është dakorduar gjerësisht se SCL në fund të fundit ka një ndikim shumë më të gjerë në hartimin dhe fleksibilitetin e kurrikulave, në përbajtjen e kursit, në metodat e përdorura për mësimnxënie dhe në konsultim me studentët.

Shpeshherë i zbrërthyer në linja të vogla të veprimit, Procesi i Bolonjës nuk është marr direkt me SCL-në që nga fillimi. Vetë koncepti ishte përfshirë ndjeshëm vetëm në komunikatën e Leuven/Louvain -la-Neuve, për Konferencën Ministrore lidhur me Procesin e Bolonjës 2009. Megjithatë, në komunikatën e miratuar në këtë takim, nuk ishte dhënë asnjë përkufizim zyrtar i SCL-së dhe referimi është bërë vetëm në aspektin e fleksibilitetit dhe të procedurave, sipas të cilave duhet të bëhen proceset e konsultimit në drejtim të reformës kurrikulare.

Pavarësisht kësaj, Procesi i Bolonjës ka arritur të përfshijë disa elemente që mund të ndihmojnë për të krijuar një sistem funksional të SCL-së. Shumë nga këto janë mjete të cilat ofrojnë fleksibilitetin e rritur të studentëve dhe mundësojnë vizibilitet më të mirë të kualifikimeve të cilat i fitojnë studentët, duke mundësuar krahasueshmërinë e rritur dhe përputhshmërinë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Ne rithekojmë rëndësinë e misionit të mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë dhe nevojën për reforma të vazhdueshme kurrikulare drejtuar kah zhvillimi i rezultateve të mësimnxënies. Të mësuarit me studentin në qendër kërkon fuqizimin individual të studentëve, qasje të reja të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, mbështetje efektive dhe struktura udhëzuese dhe një kurrikulë të fokusuar më qartë në studentët në të tri ciklet. Reforma kurrikulare do të jetë kështu një proces i vazhdueshëm që çon në metodat e arsimit me cilësi më të lartë, fleksibile dhe më të përshtatura individualisht. Akademikët, në bashkëpunim të ngushtë

me përfaqësuesit e studentëve dhe të punëdhënësve, do të vazhdojnë të zhvillojnë rezultatet e mësimin, si dhe pika ndërkombëtare të referencës që flasin për një numër në rritje të fushave të studimit. Ne kërkojmë nga institucionet e arsimit të lartë që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies së programeve të tyre të studimit në të gjitha nivelet. Kjo duhet të jetë prioritet në zbatimin e mëtejshëm të Standardeve Evropiane dhe Udhëzimeve për sigurimin e cilësisë.

Komunikatë e Leuven/Louvain -la-Neuve, 2009

Siç përshkruhët më poshtë, këto mjete janë dëshmuar si të dobishme në nxitjen e qasjes së SCL-së, pasi që reformat e frymëzuara nga Bolonja gjithashtu ofrojnë mundësi për ndryshim, duke zëvendësuar disa nga elementet tradicionalisht më të ngurta në arsimin e lartë

9.2 Si mund të ndihmojë procesi i Bolonjës në SCL?

Në konferencën e lansimit të T4SCL-së, ku një punëtori në mënyrë specifike ka adresuar lidhjen ndërmjet Procesit të Bolonjës dhe SCL-së, shumë studentë dhe mësues të cilët morën pjesë në konferencë erdhën në përfundim se zhvendosja e mentaliteteve, metodat e ndryshuara dhe rritja e fleksibilitetit në institucionet e arsimit të lartë janë jashtëzakonisht të vështira. Elementet të cilat studentët dhe stafi i identifikuan si të rëndësishme për një lëvizje drejt një qasjeje të SCL-së përfshijnë:

- Mënyrën fleksibile të të mësuarit duke u bazuar në përdorimin e rezultateve të mësimit nxënies;
- Pjesëmarrjen e studentëve në hartimin e planprogramit;
- Fokusimin në studentin individual dhe rëndësinë për të mësuarit se si të studiojnë;
- Modelet e dosjeve për vlerësim;
- Një proces i të mësuarit interaktiv i cili përfshin të mësuarit nga kolegët, dhe
- Rritjen e konsultimit dhe pjesëmarrjes së studentëve në hartimin e kurrikulave;

Përveç kësaj, përgjegjësia rritur e studentëve në lidhje me ndikimin e tyre më të madh në kurrikula në SCL është perceptuar si një element i rëndësishëm në zbatimin e qasjes së SCL-së. Zhvillimi personal i studentëve gjithashtu është identifikuar edhe si rezultat i vlefshëm i arsimit të lartë. Pjesëmarrësit theksuan se, nëpërmjet SCL-së, studentët duhet të fuqizohen dhe të jenë të pavarur, duke lejuar që kreativiteti i tyre të lulëzojë dhe duke nxitur mendimin kritik në një qasje të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Të gjitha këto janë të dëshirueshme, por nuk ekzistojnë plotësisht në sistemet e tanishme të arsimit të lartë. Disa nga këto ndryshimet e dëshiruara mund të aplikohen në lidhje me rishqyrtimin e politikave, por zgjidhja e përpjekjeve për ta bërë sistemin arsimor më fleksibil dhe me studentin në qendër mund të gjendet në mjetet dhe konceptet e ndryshme të Procesit të Bolonjës.

Siç mund të shihet më poshtë, Procesi i Bolonjës mund të ndihmojë avancimin e SCL-së pasi që ai është një sistem që ka futur ndryshimet në një numër të madh të vendeve evropiane.

plane, ku këto ndryshime, aty ku janë zbatuar siç duhet, kanë nxitur rritjen e fleksibilitetit dhe përdorimin e rezultateve në bazë të mësuarit.

9.3 ECTS DHE PËRDORIMI I REZULTATEVE TË TË MËSUARIT

Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve (ECTS) është parë shpesh si një nga mjetet më themelore nga të gjitha mjetet e Bolonjës, sepse ai është zbatuar në Proces që nga një fazë shumë e hershme. Në fakt ai i paraprin Procesit të Bolonjës pasi që ishte aplikuar i pari në kuadër të programit të shkëmbimit të Komisionit Evropian të quajtur Erasmus,

ECTS është një standard për krahasimin e arritjeve të studentëve në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Ajo ndihmon që arsimi të bëhet fleksibil duke i ofruar studentëve mundësinë për të transferuar dhe të grumbulluar kredi për njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara.

në mënyrë që të lehtësojë lëvizjen e studentëve. Që nga fillimi i Procesit të Bolonjës në vitin 1999 ka pasur një angazhim të qartë për ngritjen e një sistemi mbarë-Evropian të kredive, i cili më pas ishte vendosur të jetë modeli ECTS. Shumë vende filluan të miratojnë ECTS-në si sistem i grumbullimit dhe transferimit të kredive të tyre, që është linja e veprimit të Bolonjës që ata e zgjodhën për ta zbatuar si të parën. Megjithatë zbatimi fillestar ishte me disa të meta pasi që kishte

shumë pak praktikë të mirë në dispozicion me anë të matjes së ngarkesës së punës ose të përcaktimit të ECTS-së në aspektin e rezultateve të mësimnxënies.

Në mënyrë që kreditë e ECTS-së të përmbushin funksionin e tyre, ato duhet të jenë të bazuara në rezultatet e të mësuarit dhe ngarkesës së matur të punës. Zakonisht një ECTS konsiderohet të korrespondojë me 25-30 orë të ngarkesës së punës, që në një format të SCL-së, mund të ndryshojë bazuar në specifikat e lëndëve dhe të stileve të të mësuarit të miratuara nga studentët. ECTS do të ishte e pavlefshme pa hapat e duhur për të siguruar përdorimin e rezultateve të mësimnxënies. Vëmendje shumë e kujdesshme duhet t'i kushtohet mënyrës së si janë hartuar rezultatet e të mësuarit, në mënyrë që të lehtësojë qasjen e të mësuarit me studentin në qendër. Kjo çështje u shqyrtua më thëllësisht në Kapitullin VI më lartë.

Si mund të përfitojë SCL nga ECTS?

ECTS është një mjet fleksibil që mund të ndihmojë në masë të madhe në aplikimin e SCL-së. Përfitimet të cilat ECTS mund të sjellë në procesin e arsimit përfshijnë si në vijim:

Nuk ka mësimnxënie të humbur: ECTS iu jep studentëve mundësi që arrijtjet e tyre të të mësuarit të njihen dhe të grumbullojnë kreditë për të mësuarit e tyre;

Mobiliteti është shumë i lehtë: kreditë ECTS janë të transferueshme, duke


bërë të mundur mobilitetin e studentëve, ku janë në funksion procedurat adekuate të njohjes;

ECTS mundëson njohjen e të mësuarit të mëparshëm: Kjo futet në edukimin e studentëve nëse ata dëshmojnë se ata kishin një përvojë mësimi jashtë formatit zyrtar arsimor, duke e dhënë ECTS-në si njohje për të; dhe ECTS mundëson njohjen e gjithë spektrit të punës së studentëve që dedikohet për arrijtjen e qëllimeve të studimeve të tyre.

9.4 KORNIZAT E KUALIFIKIMEVE

Kornizat e kualifikimit janë të përfaqësuar nga sistemet që hartojnë kualifikimet ekzistuese dhe i lidhin ato me rezultatet e arritura në të mësuarit dhe nivelet e arsimit. Kornizat e kualifikimeve nuk zbatohen vetëm për arsimin e lartë, por për tërë hapësirën e niveleve të arsimit. Megjithatë jo të gjitha vendet evropiane ende nuk e kanë ngritur funksionimin e kornizave të kualifikimeve, për ato që e kanë bërë një gjë të tillë, kornizat e kualifikimit janë jetike për t'iu ofruar studentëve mënyra fleksibile të të mësuarit dhe duke u mundësuar atyre që të aplikojnë një qasje konstruktive në të mësuarit e tyre përmes një qasjeje hap pas hapi në procesin e tyre të të mësuarit. Nëse kombinohet me njohjen e mësimnxënies së mëparshme dhe përdorimin e duhur të ECTS-së, kjo mund të mundësojë efikasitet maksimal që do të zbatohet në ngarkesë e punës së studentit, duke mos e bërë të mësuarit të jetë përsëritës dhe i vendos e objektivat specifike të zbatueshme në një nivel të caktuar të kornizës së kualifikimeve.

fig. 5 Korniza e Kualifikimeve Irlandeze
Burimi: Universiteti i Kolegjit të Dublinit



9.5 SIGURIMI I CILËSISË SI NJË NDIHMË PËR SCL

Anketa e përbashkët e EI-ESU-së e kryer me organizatat anëtare në fillim të projektit T4SCL ka sjellë në pah një numër politikash dhe fushash të cilat kanë ndikim në përparimin e SCL-së. Sigurimi i cilësisë ka qenë një nga fushat më së shumti të identifikuar si reformë ndikuese në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Kjo vlenë për shkak se vlerësimet e cilësisë ndikojnë në institucione në shumë mënyra, duke përfshirë financimin dhe prestigjin institucional, në mënyrë që ajo vepron si një nxitës më shumë se çdo vijë tjetër e veprimit të Procesit të Bolonjës. Megjithatë, Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG) nuk marrin parasysh çështjet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies në mënyrë adekuate, pasi që përgjegjësia e procesit të sigurimit të cilësisë mbetet shumë procedurale, duke u fokusuar kryesisht në mekanizmat dhe rregulloret si të tilla, se sa në krijimin e një kulture të cilësisë në të gjitha nivelet.

Një hap i rëndësishëm që duhet dhe mund të ndërmerret në sigurimin e cilësisë brenda kornizës së Procesit të Bolonjës është përpjekja që të përfshijmë rekomandimet që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, përfshirjen e studentëve në hartimin e planprogrameve dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies/mësimnxënies në udhëzimet për sigurimin e cilësisë së brendshme të një institucioni të caktuar. Duke shkuar përtej minimumit të thjeshtë siç përcaktohet në ESG është një domosdoshmëri për të mundësuar sigurimin e cilësisë që të ketë një ndikim i cili shtrihet përtej procedurave burokratike.

Si mund të ndihmojnë Kornizat e Kualifikimit në SCL?

Ato theksojnë dobinë e çdo rezultati, të caktuar të të mësuarit në zhvillimin e kualifikimeve;

Ato inkurajojnë të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ndihmojnë studentët të planifikojnë karrierën e tyre dhe të mësuarit e tyre;

Ato iu ndihmojnë studentëve të zgjedhin çfarë të mësojnë bazuar në qëllimet e tyre të jetës dhe mund të bëhen një ndihmë e rëndësishme për të mësuarit e vetë-drejtuar; dhe

Nëse certifikohen në mënyrë të krahasueshme me kornizat e kualifikimeve evropiane ose ndërkombëtare, ato mund të bëhen një mjet për lëvizshmërinë vertikale dhe horizontale të studentëve duke bërë kualifikimet të lexueshme dhe të transferueshme.

Si kontribuon sigurimi i cilësisë në SCL?

Sigurimi i cilësisë është mjete kryesor i Bolonjës që ka ndikim në vendim-marrje brenda institucioneve. Aty ku cilësia mendohet të përfshijë mësimdhënien dhe mësimnxënien, ajo ka potencial për të ndikuar prioritetet institucionale;

Proceset për sigurimin e cilësisë siç janë parashikuar në Procesin e Bolonjës përvijojnë një rol të qartë për studentët, duke qenë një shembull pozitiv në përfshirjen e studentëve në proceset vendim-marrëse në institucione; dhe

Sigurimi i cilësisë ka për qëllim krijimin e një kulture të cilësisë brenda institucioneve e cila mund të çojnë në rritjen e modeleve të përdorura arsimore, duke përfshirë kalimin drejt qasjes së arsimit me studentin në qendër.

Një rrezik i madh që vjen sidomos nga hartuesit e politikave të cilët bëjnë një shoqërim të gabuar me sigurimin e cilësisë, është në formën e renditjeve, tipologjive dhe tabelave të ligës. Derisa këto kanë qenë të përjashtuara nga shumë hisedar të komunitetit akademik, ndikimi i tyre ende është shumë i madh në politikat e arsimit të lartë, duke çuar në një ri-orientim të politikave të brendshme institucionale që kanë për qëllim përmbushjen e kriterëve të përcaktuara nga renditja.

Kriteret për renditjen e institucioneve shpesh duhet të përfshijnë një fokus të veçantë në aspektet hulumtuese dhe teknike që janë të dallueshme nga aktivitetet kryesore arsimore. Pasi që mësimdhënia dhe mësimnxënia nuk ofrojnë parametra rreptësisht të matshëm, shpesh ndodh të anashkalohej ose të përfaqësohej me anë të kriterëve të cilat nuk janë plotësisht relevante. Kjo ka potencialin të shkaktojë shumë dëme nëse këto renditje duhet të rrisin pushtetin e tyre mbi sigurimin e cilësisë si proces me të cilin institucionet i vlerësojnë rezultatet e tyre dhe përcaktojnë qëllimet e tyre.

9.6 NJOHJA E TË MËSUARIT TË MËPARSHËM

Një nga premiset e para që duhet të tejkalohet në mënyrë që të aplikojmë SCL-në në mënyrë adekuate është ajo me të cilën institucionet e arsimit të lartë pretendojnë një monopol në të mësuarit. Të mësuarit, në aspektin e njohurive të fituara në nivel individual, bëhet në formate shumë më të mëdha sesa në klasë, por shpesh kjo njihet vetëm kur ndodh në hapësirat akademike.

Njohja e të mësuarit të mëparshëm (RPL) është mjaft e përhapur për punësim ose për qëllime edukative, por ajo është përdorur rrallë për të ushqyer rezultatet e mësimnxënies në një grup koherent të kualifikimeve që studenti i fiton si rezultat i procesit të të mësuarit. Kjo është, në qoftë se rezultatet e mësimit X, Y dhe Z çojnë në kompetencën W, shumica e studentëve në Evropë kanë nevojë për të arritur të tri rezultatet në institucionin e tyre, në vend se të kontribuojnë nëpërmjet rezultatit të të mësuarit Z nga përvojat e jashtme. Vlen të përmendet se RPL nuk është e lidhur thelbësisht me zhvillimin e Kornizës Kombëtare

Cila është vlera që RPL sjell në SCL?

Ajo mund të ndihmojë studentët të plotësojnë të mësuarit në mjedisin akademik me të mësuarit informal që ndodh në situata të jetës reale, duke i dhënë studentit më shumë kontroll mbi mënyrën e arritjes së rezultateve të caktuara të të mësuarit; Ajo lehtëson përfundimin e suksesshëm

të arsimit të lartë për studentët me një sfond të përgjithshëm, siç janë ata që fillojnë të punojnë pas mbarimit të arsimin e mesëm; dhe

E përdorur së bashku me ECTS dhe kornizat e kualifikimeve, ajo mund të bëhet një mjet i rëndësishëm në mbështetjen e të mësuarit të vetë-drejtuar.

të Kualifikimeve gjithëpërfshirëse, edhe pse referimi i RPL-së në një nivel specifik për të mësuarit e një kualifikimi të caktuar mund të dal se është dyfish i dobishëm.

Në përgjithësi, përdorimi më i mirë i RPL-së për të ndihmuar funksionimin e SCL-së mund të jetë duke e përdorur atë që të njohim (pranojmë) rezultatet e të mësuarit për qasje në studimet e arsimit të lartë dhe për kontributin e tyre në fitimin e kualifikimeve të ndryshme brenda sistemit arsimor.

9.7 Mobiliteti i studentëve dhe stafit

Mobiliteti është dëshmuar të jetë një përvojë e vlefshme për studentët dhe stafin. Në fakt, mobiliteti i studentëve dhe stafit është një nga mjetet më të mira për të shkëmbyer shembujt e praktikave të mira në mësimdhënie dhe mësimnxënie në Evropë, duke mundësuar analizimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe të zbatohen ato në kontekste të ndryshme. Mobiliteti është një mjet plotësues për qasjen shkencore të raportimit dhe analizës së qasjeve të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Nuk duhet të përdorim qasjet provo dhe gabo në zbatimin e qasjeve të ndryshme arsimore në institucione në qoftë se shembujt funksional nga institucionet e tjera mund të studiohen nga kontakti i drejtpërdrejtë.

Në qasjen e SCL-së, studentët mobil gjithashtu kanë mundësi të japin të dhëna dhe reagime kthyes bazuar në përvojat e mobilitetit të tyre, në mënyrë që të japin ide se si mund të ndryshojnë praktikat arsimore brenda institucionit të tyre. Për personat e angazhuar në programet e mobilitetit, një vlerë e shtuar përfaqësohet nga mundësia për të studiuar në mjedise të ndryshme me njerëz të ndryshëm dhe duke përdorur metoda të ndryshme.

Është e rëndësishme që të diskutohen përvojat lidhur me një periudhë të mobilitetit të cilën e përjetojnë studentët dhe mësimdhënësit në një institucion të ndryshëm. Në mënyrë që mobiliteti të ketë një ndikim konkret mbi institucionet e përfshira, është me rëndësi jetike që të vëzhgojmë, raportojmë dhe të diskutojmë çfarë është mësuar gjatë periudhës së mobilitetit. Bashkëpunimi i rritur që ndjek shkëmbimin e praktikave të mira gjithashtu ofron mundësi të zgjeruara për mobilitetin e stafit dhe të studentëve.

Mobiliteti dhe SCL-ja

Ajo është një mjet i mirë për shkëmbimin e shembujve të praktikës së mirë midis institucioneve dhe individëve, duke ofruar përvojat pozitive që janë ndjekur dhe të cilat në të vërtetë i ndikojnë praktikat në mësimdhënie dhe mësimnxënie;

Kjo iu jep studentëve mundësi për të studiuar në mjedise të ndryshme dhe i ndihmon ata të përballen me metoda dhe kontekste të ndryshme arsimore; dhe

Në vetvete, ajo zhvillon aftësitë e ndryshme komplementare me ato të arritura në procesin mësimor (p.sh. shkathtësitë gjuhësore, kapaciteti për të punuar në mjedise të ndryshme dhe komunikimi ndër-kulturor).

9.8 DIMENSIONI SOCIAL DHE SCL-ja

Një nga elementet e Procesit të Bolonjës i cili shpesh është lënë mënjanë dhe i cili ende është më i nevojshmi për të zbatuar SCL-në në mënyrë efektive është dimensionin funksional social në arsimin e lartë. Studentët me prapavijë të pafavorizuar shpesh fillojnë studimet e tyre në arsimin e lartë me disa disavantazhe të rënda dhe shpesh duhet të ekspozohen ndaj stileve të ndryshme të të mësuarit dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë që të kenë sukses. Studentët që janë të punësuar ose që kanë përgjegjësi familjare gjithashtu kërkojnë fleksibilitet shtesë në shtigjet e tyre të të mësuarit dhe mund të kenë nevojë që studimet e tyre të shtrihen gjatë disa viteve, në mënyrë që të kombinojnë angazhimet e tyre të vazhdueshme me studimet e tyre në mënyrë efektive.

Shqyrtimi i dimensionit social është i rëndësishëm në mënyrë që arsimit fleksibil të vihet në dispozicion për ata që kanë shumë kohë për të mësuar, si edhe për ata që kanë kohë të kufizuar dhe burime për të mbështetur studimet e tyre. Dimensionin social duhet të gërmojë vetë në procesin arsimor, duke iu referuar jo vetëm qasjes në arsimin e lartë, por edhe për përparimin e suksesshëm në të gjitha nivelet e arsimit të lartë. Një nga elementët më të rëndësishëm në këtë drejtim është përshtatja e metodave të të mësuarit për grupe të ndryshme të studentëve. Duke përdorur një rrugë të vetme për të arritur rezultatet e mësimit është pothuajse e sigurt se disa grupe të studentëve do të vihen në një disavantazh.

Dimensionin social, në qoftë se kuptohet në një kuptim të gjerë dhe në qoftë se merr parasysh aspektet sociale dhe edukative të jetës së studentëve, mund të ketë një ndikim pozitiv në përfshirjen e procesit arsimor, duke e përshtatur atë me të gjitha llojet e ndryshme të studentëve, jo vetëm me ata që përfitojnë nga arsimi i mesëm optimal dhe financat adekuate personale.

Lidhja ndërmjet dimensionit social dhe SCL-së

Kjo është e nevojshme për të garantuar që asnjë student nuk i fillon studimet e tij/saj me ndonjë disavantazh; Kjo duhet të shkojë përtej masave të mbështetjes sociale dhe gjithashtu të adresojë procesin arsimor. Studentët që kanë prapavijë të pafavorizuar shpesh e kanë nivelin e arsimit të mesëm të dobët ose një mjedis të vështirë famil-

jar, që duhet të mirret parasysh në planifikimin e metodave të mësimdhënies që do të përdoren; dhe

- Ofrimi i mbështetjes adekuate sociale siguron që studentët mund t'i kushtojnë kohë të mjaftueshme mësimnxënies në krahasim me të qenurit të kushtëzuar në lidhje me kohën që ata kanë në dispozicion për të mësuarit e tyre.

10. BURIMET PËR LITERATURË TË MËTEJSHME

- Uebfaqja e DORACAKUT TË BOLONJËS: <http://www.bologna-handbook.com>
- BRANDES, D. dhe GINNIS, P. (1986) Udhëzuesi për të Mësuarit me Studentin në Qendër (Oxford, Blackwell)
- Uebfaqja e AKADEMIKË BRITANIKE E ARSIMIT TË LARTË: <http://www.heacademy.ac.uk>
- DE GRAFF, E. dhe KOLMOS, A. (eds.) (2007) Menaxhimi i Ndryshimit: Zbatimi i të mësuarit bazuar në problem dhe bazuar në projekte në Inxhiniering. (Rotterdam, Sense Publishers)
- EI (2010) Rritja e cilësisë: Perceptimet e Akademikëve për Procesin e Bolonjës. (Bruksel, Education International)
- EI, ESU (2010) Të Mësuarit me Studentin në Qendër. Pasqyrë e Teorisë dhe Praktikës. (Bruksel, Education International, Unioni i Studentëve Evropian)
- ENQA (2005) Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. (Helsinki, Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë)
- ENQA (2009) Çështjet e Vlerësimit: Sigurimi i Cilësisë të Vlerësimit të Studentëve në Arsimin e Lartë. Raport i një Grupi Punues Ndërkombëtar (Helsinki, Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë)
- ESU (2009) Bolonja dhe Pika e Cakut. (Bruksel, Unioni i Studentëve Evropian)
- KOMISIONI EVROPIAN (2009) Udhëzuesi për Përdoruesit të Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. (Bruksel, Komunitetet Evropiane)
- Uebfaqja e UNIONIT TË STUDENTËVE EVROPIAN: <http://www.esu-online.org>
- Uebfaqja e ASOCIACIONIT TË UNIVERSITETEVE EVROPIANE: <http://www.eua.be>
- GIBBS, G. (1995) Vlerësimi i Kurseve me Studentët në Qendër. (Oxford, Qendra e Oksfordit për Zhvillimin dhe të Mësuarit e Stafit)
- HENRIKSEN, L.B., NØRREKLIT, L., JØRGENSEN, K. M., CHRISTENSEN, J. B. Dhe O'DONNELL, D. (2004) Dimensioni i Ndryshimit – Konceptualizimi i Realitetit në Organizatat Hulmuese. (Kopenhagën, Shkolla e Kopenhagës për Biznes)
- KEMBER, D. (2008) 'Promovimi i formave të të mësuarit me studentin në qendër përgjatë tërë Universitetit. Në: Arsimin e Lartë, 58, fq.1-13.
- LAVOIE, D. dhe ROSMAN, A.J. (2007) 'Përdorimi i Dizajnit Instruksional për të Mësuarit me Studentin në Qendër për të Zhvilluar Fakultetin dhe për të Përmirësuar Dizajnin, Mbajtjen dhe Vlerësimin e Kursit. Në: Çështjet në Arsimin e Kontabilitetit, 22:1, fq.105-118.
- LEA, S. J., STEPHENSON, D. dhe TROY, J. (2003) 'Qëndrimet e Studentëve të Arsimit të Lartë ndaj Të Mësuarit me Studentin në Qendër: Përtej Bulimia-së Arsimore'. Në: Studime në Arsimin e Lartë, 28(3), fq. 321–334.

- MOUST, J.H.C., Van BERKEL, H.J.M dhe SCHMIDT, H.G. (2005) 'Shenjat e Erozionit: Reflektime mbi tre dekada të të mësuarit bazuar në problem në Universitetin e Mastrihtit'. Në: Arsimi i Lartë, 50, fq.665-683.
- O'NEILL, G. dhe McMAHON, T. (2005) 'Të Mësuarit me Studentin në Qendër: Çfarë do të thotë për studentet dhe pedagogët'? Në: O'Neill, G., Moore, S., Mc Mullin, B. (eds). Çështjet e reja në praktikën e të mësuarit dhe mësimdhënies në Universitet. (Dublin, AISHE)
- ROGERS, C.R. (1983) Liria për të mësuar për 80-at. (Columbus, OH: Charles Merrill)
- SANTIAGO, P., TREMBLAY, K., BASRI, E., dhe ARNAL, E., (2008) Arsimi Terciar për Shoqërinë e informacionit: OECD Rishikimi tematik i arsimit terciar. Raporti sintezë. Vëll.2. (Paris, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik)
- UNIVERSITETI I ADELAIDES (2000) Hyrje në ... të Mësuarit me Studentin në Qendër (Adelaide, Universiteti i Adelaides)
- Uebfaqja e QENDRËS SË KOLEGJIT UNIVERSITAR TË DUBLINIT PËR MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE: <http://www.ucd.ie/teaching>
- UNIVERSITETI I GLASGOUT (2004) Të Mësuarit me Studentin në Qendër. <http://www.gla.ac.uk/otherdepts/TLS/Project/Reports>

Koha për një Paradigmë të Re në Arsim: Të mësuarit me studentin në qendër (T4SCL), është projekt i udhëhequr nga Unioni i Studentëve Evropianë (ESU) dhe Arsimi Ndërkombëtar (Education International - EI). Projekti bazohet në nevojën për të qartësuar dhe thelluar të kuptuarit nga komuniteti akademik dhe nga hartuesit e politikave për mënyrën praktike në të cilën mund të zbatohet kjo qasje e të mësuarit dhe përfitimet që prodhon për studentët, mësuesin, institucionet dhe shoqërinë në tërësi.

www.esu-online.org;

www.ei-ie.org

